

## **Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut**

### **Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit**

**Kosovë**

**Raport vjetor 2017**

**1 janar - 31 dhjetor 2017**

**Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut – Sekretariati**

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +383 (0) 38 28 2207

Email: [office@hrrp.eu](mailto:office@hrrp.eu)

[www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu)

## Parathënie

Ky është raporti vjetor i tetë i përgatitur nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) për periudhën 1 janar 2017 deri 31 dhjetor 2017, i cili publikohet për opinionin me qëllim të shpërndarjes së informatave rreth zhvillimeve në praktikën gjyqësore të Panelit.

Bashkimi Evropian e ka themeluar Panelin më 29 tetor 2009 me mandatin për t'i shqyrtuar ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganës që kanë ekzistuar në atë kohë. Paneli është mekanizmi i parë, si dhe deri më tani i vetmi i këtij lloji për shqyrtimin e ankesave lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga një mision i Politikës së Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje me kompetenca ekzekutive.

Së bashku me Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ky është njëri prej vetëm dy paneleve ndërkombëtare që janë mandatuar ndonjëherë që të mbajnë përgjegjësi organizatat ndërkombëtare, të cilat vepronë me role ekzekutive, në lidhje me pretendimet për shkelje të drejtave të njeriut. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut e përfundoi mandatin më 30 qershor 2016, që do të thotë se ky Panel tani është organi i vetëm i këtij lloji i llogaridhënies për të drejtat e njeriut që është në funksion.

Pamundësia e Panelit që pas konstatimit të ndonjë shkeljeje të rekomandoj që të paguhet kompensim financiar për viktimat, siç parashihet në kornizën ligjore fillestare në bazë të cilës është krijuar Paneli në vitin 2008 (shih kapitujt 2.1 dhe 1.2 më poshtë), vazhdon ta kufizojë mundësinë e Panelit që t'ju ofrojë viktimave një kompensim adekuat në disa raste të shkeljeve të të drejtave. Ndonëse viktimat marrin një lloj ngushëllimi nga fakti se pretendimet e tyre për shkelje arsytohen nga Paneli, në shumë raste kjo gjë është e pamjaftueshme. Gjendja përkeqësohet nga fakti se rekomandimet e Panelit për shëfën e Misionit (ShM), EULEX-i Kosovë, që të kërkohet falje për shkeljet e të drejtave të njeriut apo që të pranohet se ka ndodhur shkelja, deri më tani nuk janë zbatuar.

Megjithatë, përgjatë tërë periudhës raportuese, ShM-ja dhe stafi i saj kanë vazhduar bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Panelin. Këtu përfshihet dhënia me kohë e përgjigjeve apo e vërejtjeve në lidhje me lëndët që i janë komunikuar Misionit. Paneli në veçanti e përshëndet ofrimin me kohë të dokumenteve që ndërliken me thelbin e lëndëve në shqyrtim e sipër, përfshirë raportet e policisë dhe materialet e tjera lidhur me lëndët që janë në shqyrtim e sipër. Dua ta shfrytëzoj rastin ta falënderoj ShM-në për bashkëpunimin e saj me Panelin dhe angazhimet e bëra nga ana e saj për zbatimin e shumicës së rekomandimeve të Panelit gjatë kësaj periudhe raportuese.

Paneli ka vazhduar me praktikën e takimeve me zyrtarët e lartë të EULEX-it dhe në këtë drejtim i ka mbajtur dy takime me shëfën e Misionit, si dhe takime të tjera me shëfin e Divizionit Ekzekutiv dhe shëfin e Zyrës Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut.

Sa i përket numrit të lëndëve në Panel, gjatë vitit 2017 janë pranuar shtatë ankesa të reja. Paneli i ka përfunduar njëzet e pesë raste dhe ka konstatuar se EULEX-i kishte kryer shkelje të të drejtave të njeriut në dy lëndë. Po ashtu, ai ka konstatuar se në nëntë lëndë nuk ka pasur shkelje, ndërsa katërbëdhjetë lëndë ishin të papranueshme. Numri i tanishëm i lëndëve është tridhjetë.

Në përputhje me praktikën standarde dhe duke vepruar sipas rregullit 34 dhe rregullit 45 e *tutje* të Rregullores së Punës së vet, Paneli ka bërë rekomandime korrigjuese të hollësishme shëfes së

Misionit të EULEX-it Kosovë për këto dy lëndë që kishin të bënin me shkelje të drejtave të njeriut, si dhe e ka bërë vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të tij që i ishin dhënë shefes së Misionit në disa prej vendimeve të mëhershme të tij.

Paneli është ballafaquar me vështirësi të mëdha për shkak të reduktimeve të stafit si rezultat i rikonfigurimit të EULEX-it në vitin 2016 që ka sjellë deri te largimi i 33% të stafit nga Sekretariati. Kjo situatë është komplikuar edhe më shumë nga dorëheqja dhe zëvendësimi i një zyrtari ligjor, gjë që në fakt do të thotë se Sekretariati ka funksionuar me vetëm një zyrtar ligjor gjatë pjesës më të madhe të periudhës raportuese.

Nga Paneli është larguar anëtarja që ka shërbyer gjatë, znj. Elka Ermenkova, ish-gjykatëse e çështjeve penale në Gjykatën Supreme/Gjykatën e Apelit të Kosovës, e cila ka dhënë dorëheqje për ta pranuar detyrën e vëzhgueses ndërkombëtar në kuadër të Misionit Monitorues të Komisionit Evropian në Shqipëri. Dëshiroj ta falënderoj atë për punën e shkëlqyeshme dhe kontributin e saj në Panel. Njohuritë e saj të gjera për Misionin, të kaluarën dhe kontekstin ligjor dhe institucional ishin pjesë e rëndësishme e kontributit të saj për punën e Panelit. Unë shfrytëzoj rastin që zj. Ermenkova t'i uroj shumë suksese në karrierën e saj.

Më vonë gjatë këtij viti, në dhjetor 2017, z. Jorge Martins Ribeiro, gjykatës i EULEX-it, u caktua në Panel si anëtar zëvendësues.

Po ashtu, nga Paneli është larguar znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore, e cila ka dhënë dorëheqje nga Paneli për t'u punësuar si këshilltare për Bashkëpunim Gjyqësor në EUROJUST, agjenci e Bashkimit Evropian, (BE), Hagë, Holandë. Gjithashtu, dëshiroj të shfrytëzoj rastin ta falënderoj znj. Aarnio për kontributin e saj në Panel dhe t'i uroj suksese.

Magda Mierzevska  
Anëtare kryesuese  
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

## Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	2
1. Korniza rregullative.....	5
1.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-i Kosovë.....	5
1.2. Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009.....	5
1.3. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut .....	5
2. Numri i rasteve dhe lënda e ankesave .....	6
2.1. Numri i rasteve dhe statistikave.....	6
2.2. Lënda e ankesave .....	7
3. Jurisprudenca .....	8
3.1. Hyrje.....	8
3.2. Vendimet mbi bazueshmërinë e lëndëve .....	8
4.3. Vendimet për pranueshmërinë.....	13
4.4. Vendimet për zbatimin e rekomandimeve të Panelit.....	14
4.5. Lëndët e hequra nga lista.....	18
4.6. Publikimi i lëndëve të Panelit nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut - seksionet e praktikës gjyqësore të juridiksioneve të tjera:.....	19
6. Aktivitetet e tjera të Panelit .....	20
6.1 Takimet .....	20
6.2. Fushata informuese e vitit 2017 .....	21
6.3. Trajnimi hyrës .....	21
6.4. Faqja e internetit e PShDNj-së .....	21
7. Emërimet gjyqësore në Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar .....	22
8. Paneli dhe Sekretariati .....	24
8.1. Anëtarët e Panelit .....	24
8.2. Sekretariati.....	27
8.3. Ish-personeli i Panelit dhe Sekretariatit.....	28
9. Çështjet operative dhe administrative .....	33
9.1. Buxheti .....	33
9.2. Burimet njerëzore .....	33
10. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	33
SHTOJCA 1 Tabela e personelit për vitin 2017 .....	40
SHTOJCA 2 Statistikat 2010 - 2017 .....	41
SHTOJCA 3 Vendimet nga PShDNj-ja 2010-2017.....	42

## 1. Korniza rregulative

### 1.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-i Kosovë

Veprimi i përbashkët i Këshillit është burimi i autoritetit dhe kompetencave të Misionit EULEX-i Kosovë. Në atë veprim përcaktohet *mandati* i EULEX-it Kosovë dhe, *ndër të tjera*, specifikohet përgjegjësia e tij për të vepruar në përputhje me standardet përkatëse për të drejtat e njeriut, neni 3 (i): “*të sigurojë që të gjitha aktivitetet e tij t’i respektojnë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe përfshirjen gjinore*”.

### 1.2. Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009

Themelimi i një mekanizmi të pavarur, efektiv dhe transparent për llogaridhënie në lidhje me të drejtat e njeriut ishte konsideruar të jetë kriter themelor për EULEX-in Kosovë si mision për sundim të ligjit me disa funksione ekzekutive të kufizuara. Ky mekanizëm i jashtëm i llogaridhënies kishte për qëllim plotësimin e llogaridhënies së përgjithshme të Misionit EULEX-i Kosovë, siç parashihet me Skemën e Sigurimit të Përgjegjësive për Palën e Tretë dhe Mekanizmin e Brendshëm Disiplinor të EULEX-it.

Andaj, Koncepti i llogaridhënies përcaktoi *mandatin* e Panelit që: *të shqyrtojë ankesa nga çdo person, që nuk është pjesë e personelit të EULEX-it Kosovë, që pretendon të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë*.<sup>1</sup>

Megjithatë, sipas Konceptit të llogaridhënies, Paneli nuk ka juridiksion në lidhje me gjykatat e Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it janë anëtarë të trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave si gjykata të Kosovës<sup>2</sup>.

Paneli e ka miratuar Rregulloren e Punës së tij më 10 qershor 2010, ku pas kësaj date Paneli është autorizuar të pranojë ankesa. Paneli i ka ndryshuar rregullat e veta më 21 nëntor 2011 dhe 15 janar 2013.

### 1.3. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Në pajtim me dispozitat e Konceptit të llogaridhënies, Paneli mund të shqyrtojë ankesa në lidhje me pretendime të shkeljeve, në mes të tjerash, të instrumenteve të të drejtave të njeriut si në vijim:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)
- Konventa Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa, 1950)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965)

<sup>1</sup> Koncepti i llogaridhënies është pjesë e planit operacional të EULEX-it. Ai është dokument i kufizuar dhe nuk është i qasshëm për publikun. Paneli nuk e ka lirinë për zbulimin e detajeve që përmbahen aty.

<sup>2</sup> Shih lëndën nr. 2016-08, Hamdi Hasani kundër EULEX-it; 2016-25, Hilmi Krasniqi kundër EULEX-it; 2016-26, T.G. kundër EULEX-it; 2016-27 Afrim Islami kundër EULEX-it; 2016-33, Agron Bytyçi kundër EULEX-it; 2016-36, Namon Statovci kundër EULEX-it dhe 2017-03, Alfred Bobaj kundër EULEX-it. (fusnota & jurisprudenca).



- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (MDCP, 1966)
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (MDESK, 1966)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Femrave (KEFDF, 1979)
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit tjetër Mizor, Çnjerëzor apo poshtërues (KKT, 1984)
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës (KDF, 1989)

Në praktikë, ankesat që janë paraqitur deri më sot kryesisht janë thirrur në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollat e saj. Një numër i ankesave po ashtu janë thirrur në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, marrëveshjet ndërkombëtare dhe instrumentet e tjera për të drejtat e njeriut.

## 2. Numri i rasteve dhe lënda e ankesave

### 2.1. Numri i rasteve dhe statistikat

Gjatë vitit 2017, Paneli ka regjistruar shtatë ankesa të reja. Paneli i ka përfunduar njëzet e pesë (25) raste nga numri i rasteve të tij dhe ka konstatuar se EULEX-i kishte kryer shkelje të drejtave të njeriut në dy (2) raste. Po ashtu, ai ka konstatuar se në nëntë (9) raste nuk ka pasur shkelje, ndërsa katërbëdhjetë (14) raste ishin të papranueshme. Numri aktual i rasteve është tridhjetë.



## 2.2. Lënda e ankesave

Llojet më të zakonshme të ankesave që pretendojnë shkelje të të drejtave të njeriut, të cilat janë shqyrtuar nga Paneli në vitin 2017 kishin të bënin me personat e vrarë dhe të pagjetur. Ato kanë ngritur pretendime veçanërisht të rënda për shkelje të drejtave të njeriut dhe janë jashtëzakonisht të rëndësishme në situatat pas konfliktit si ajo në Kosovë. Më poshtë është përmbledhur shkurtimisht lënda e rasteve të Panelit përkitazi me rastet që janë shqyrtuar gjatë vitit raportues:

- Shkelje të pretenduara të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me nenin 13: lënda [Thomas Rusche kundër EULEX-it, nr. 2013-21](#);
- Shkelje të pretenduara të nenit 2 dhe 3 të Konventës: lënda [F. dhe të tjerëve kundër EULEX-it, nr. 2011-27](#);
- Shkelje të pretenduara të së drejtës për jetë (neni 2 i Konventës; neni 6 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike); lëndët [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11 deri 2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#), nr. 2014-34; [Mustafa-Sadiku kundër EULEX-it](#), nr. 2014-41;
- Shkelje të pretenduara të së drejtës për ndalimin e torturës, trajtimin çnjerëzor apo poshtërues (neni 3 i Konventës; neni 7 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike; neni 6 par. 1 dhe 2 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo degraduese): lëndët [Stanisić kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri T\) kundër EULEX](#), nr. 2013-05 to 2013-14; të [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11 deri 2014-17; [L.O. kundër EULEX](#) nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#), nr. 2014-34; [Mustafa-Sadiku kundër EULEX-it](#), nr. 2014-41;
- Shkelje të pretenduara të së drejtës për liri dhe siguri (neni 5, par. 1c, 2, 3 dhe 4 të Konventës; neni 9, par. 2 deri 4 të Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike): lëndët [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 deri 2013-14; [Krasniqi kundër EULEX-it](#), nr. 2014-33;
- Shkelje të pretenduara të së drejtës për gjykim të drejtë dhe qasje në gjykatë (neni 6 i Konventës; neni 14 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike): rastet [X dhe 115 ankuesit e tjerë kundër EULEX-it](#), nr. 2011-20; [Radunović kundër EULEX-it](#), nr. 2014-02; [Ibrahimi kundër EULEX-it](#), nr. 2014-05; [Maksutaj kundër EULEX-it](#), nr. 2014-18; [J.Q. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-24; [Kaçiu kundër EULEX-it](#), nr. 2014-26; [Shabani kundër EULEX-it](#), nr. 2014-30; [K.P. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-31; [Mikić kundër EULEX-it](#), nr. 2014-38; [Hajdari kundër EULEX-it](#), nr. 2014-40;
- Shkelje të pretenduara të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 i Konventës; neni 17 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike): lëndët [Stanisić kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11-2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#), nr. 2014-34; [Y.B. kundër EULEX nr. 2014-37](#);
- Shkelje të pretenduara të së drejtës për lirinë e të menduarit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 9 i Konventës; neni 18 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike): lëndët [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 to 2013-14;

- Shkeljet e pretenduara të së drejtës për mjete juridike efektive (neni 13 i Konventës) në lidhje me:
  - Neni 6: [X dhe 115 ankuesit e tjerë kundër EULEX-it](#), nr. 2011-20; [Radunović kundër EULEX-it](#), nr. 2014-02; [Ibrahimi kundër EULEX-it](#), nr. 2014-05;
  - Neni 8: [Stanisić kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11 to 2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#), nr. 2014-34;
- Shkelje të pretenduara të së drejtës për trajtim të barabartë (neni 14 i Konventës; neni 26 i Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike): [Stanisić kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri në T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 deri 2013-14; [Radunović kundër EULEX-it](#), nr. 2014-02; [Ibrahimi kundër EULEX-it](#), nr. 2014-05;
- Shkelje të pretenduara të së drejtës për gëzimin paqësor të posedimeve të tyre (neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës): [Begolli kundër EULEX-it](#), nr. 2014-27; [Musa kundër EULEX-it](#), nr. 2014-29; [Zherka kundër EULEX-it](#), nr. 2014-42.

Një numër i ankuesve iu kanë referuar, në mënyrë të përgjithësuar, instrumenteve të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

### 3. Jurisprudenca

#### 3.1. Hyrje

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Paneli ka vazhduar me zhvillimin e jurisprudencës së tij dhe ka nxjerrë një numër të vendimeve për bazueshmërinë e lëndës, vendime për pranueshmërinë, si dhe vendime për zbatimin e vendimeve të tij nga shefja e Misionit. Gjatë shqyrtimit të ankesave gjatë periudhës raportuese, Paneli është mbështetur në mënyrë të konsiderueshme në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ), praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), të drejtën ndërkombëtare/e drejta për konfliktet e armatosura, praktikën gjyqësore të tij, si dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.

#### 3.2. Vendimet mbi bazueshmërinë e lëndëve

##### Lënda nr. [2013-21 Thomas Rusche kundër EULEX-it](#)

##### I. FAKTET

Më 28 prill 2006, ankuesi e kishte nënshkruar një kontratë me I.F. dhe M.L. për themelimin e kompanisë me përgjegjësi të kufizuar MTI Stone and Building (MTI) (në tekstin e mëtejshme “kompania”). Ata ishin pajtuar që të jenë pronarë të barabartë të aksioneve të kësaj kompanie (me nga 33% secili).

Ankuesi më pas i ka zbuluar veprimtaritë e pohuara kriminale të partnerëve të tij të biznesit, ashtu që ata janë përpjekur që ta largojnë atë nga kompania nëpërmjet falsifikimit të neneve lidhur me bashkimin e kompanisë si dhe duke bërë kërcënime ndaj tij.



Ankuesi ka pretenduar se më pas atij nuk i është lejuar që t'i ushtrojë funksionet e tij si drejtor Ekzekutiv. Gjithashtu, atij nuk i ishte dhënë qasje në dokumentet dhe pasqyrat financiare dhe i ishte refuzuar hyrja në mjediset e kompanisë. Më 3 nëntor 2010, ankuesi ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve për ta kthyer atë si aksionar të kompanisë dhe për ta shfuqizuar vendimin e saj të mëparshëm. Pas kësaj kërkesë, ushtruesi i kryeshefit ekzekutiv të kësaj Agjencie, e ka kthyer kompaninë në statusin juridik të mëparshëm të saj, ku ankuesi u kthye si aksionar i 33% të aksioneve. Më 16 qershor 2015, Gjykata Ekonomike i akordoi ankuesit shumën prej 874,000 EUR si kompensim për dëmet e shkaktuara atij, ndërsa e drejta e pronësisë së të pandehurve M.L. dhe I.F. mbi aksionet e kompanisë u anulua. Ankesa është regjistruar në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Panel) më 12 gusht 2013.

## **II. ANKESAT**

Ankuesi pohon se misioni EULEX-i Kosovë nuk e ka mbrojtur të drejtën e tij për t'i gëzuar në mënyrë paqësore pasuritë e tij të garantuar në bazë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"). Po ashtu, ai është ankuar se EULEX-i i ka shkelur të drejtat e tij për zgjidhje efektive e garantuar me Nenin 13 të Konventës. Meqë kjo ankesë përbëhet prej dy elementëve të ndarë, ajo është shqyrtuar si dy lëndë të ndara (Lënda nr. PPS 26/2010 dhe lënda nr. PPS 360 /2012).

## **III. PRANUESHMËRIA**

Paneli ka konstatuar se ankesa bën pjesë në kuadër të mandatit të tij dhe se i plotëson kriteret e pranueshmërisë ashtu siç janë të përcaktuara në Rregulloren e tij të Punës. Në këtë kontekst, Paneli vlerëson se veprimet ndaj të cilave është bërë ankesa kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me veprimet e prokurorëve të EULEX-it gjatë ushtrimit të funksioneve ekzekutive të tyre. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1 të Rregullores së tij të Punës, ankesat mund të parashtrohen në Panel nga çdo person përveç personelit të misionit EULEX-i Kosovë, i cili pretendon se është viktimë e shkeljes së drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij. Paneli ka konstatuar në disa raste më parë se veprimet e ndërmarra nga ndonjë prokuror i EULEX-it gjatë shqyrtimit të një lënde janë pjesë e mandatit ekzekutiv të misionit EULEX-i Kosovë dhe se këto veprime bëjnë pjesë në kuadër të mandatit të Panelit deri kur të ngritët dhe të përsirë ngritjen e aktakuzës në ndonjë gjykatë kompetente për të shqyrtuar bazueshmërinë e një lënde.

## **IV. VLERËSIMI NGA PANELI**

### *Pritshmëritë reale për hetime nga organizatat ndërkombëtare – EULEX-i nuk është shtet*

Për aq sa ankuesi është ankuar në bazë të nenit 13 të Konventës, Paneli tashmë ka pasur raste kur ka theksuar se misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se mundësia e tij për të garantuar mbrojtje efektive të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritët nga një shtet. Paneli nuk ia imponon autoriteteve hetimore të EULEX-it obligimin për të hetuar deri në atë masë që e tejkalon mandatin dhe resurset e tij. Prandaj, Paneli është dashur të shqyrtojë nëse ekzistojnë pengesa të cilat mund t'i pengonin kapacitetet e EULEX-it për të kryer hetime të shpejta dhe efektive. Ky vlerësim nuk ka për qëllim t'i arsyetojë mangësitë operacionale që nuk ndërlidhen me sfidat konkrete, por për të siguruar që nga EULEX-i të mos pritët të bëjë më shumë se sa atë që në mënyrë të arsyeshme ia mundëson ta bëjë mandati i tij. Paneli ka theksuar se ky rast përfundimisht i ishte caktuar një gjykatësi të EULEX-it, dhe se rasti ka qenë mjaft i rëndë që të merret përsipër nga EULEX-i, veprim ky që është i rezervuar për rastet penale më të rënda.

Paneli ka theksuar se ankuesi e ka kontaktuar EULEX-in në shtator 2009, kurse hetimet nuk kishin filluar deri më 23 shkurt 2010. Hetimet ishin pezulluar më 4 gusht 2011 megjithëse disa veprime hetimore kishin vazhduar edhe më pas. Hetimet kishin rifilluar zyrtarisht më 14 dhjetor 2014 dhe me sa dihet vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. EULEX-i nuk ka paraqitur ndonjë parashtrësë përkitazi me atë se çfarë veprimesh janë ndërmarrë ose jo në ndërkohë derisa Gjykata Ekonomike ia akordoi ankuesit 874,000.00 Euro më 16 qershor 2015.

#### **V. Përfshirja/përfaqësimi i ankuesit**

Paneli ka konstatuar më tej se ankuesi dhe avokati i tij nuk ishin ftuar që të merrnin pjesë gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve kur ishin intervistuar në lidhje me hetimin e dytë në rastin nr. (PP 360/2012). Nuk është bërë e ditur nëse ankuesi apo avokati i tij janë informuar lidhur me këto intervistime dhe nëse jo përse nuk ishin informuar. Po ashtu, nuk është sqaruar se pse të dyshuarit nuk ishin intervistuar në lidhje me hetimin e rastit të parë, rasti nr. PPS. 26/2010, në kohën kur të dy të dyshuarit ishin në Kosovë dhe në dispozicion për t'u intervistuar.

#### **VI. Vendimi mbi bazueshmërinë**

Paneli konstatoi se ka pasur shkelje të së drejtës së ankuesit për zgjidhje efektive të garantuar me anë të nenit 13 të Konventës. Duke i pasur parasysh këto gjetje të tij sipas nenit 13, Paneli ka vlerësuar se nuk ishte e nevojshme që të shqyrtohej ankesa sipas nenit 1 të protokollit 1 të Konventës. Prandaj, Paneli e vlerësoi të përshtatshme që, duke i marrë parasysh gjetjet e mësipërme të tij për faktet dhe ligjin, t'ia bënte këto rekomandime shefes së Misionit sipas Rregullës 34 të Rregullores së tij të Punës:

Që SHM-ja ta bënte një deklaratë se e pranon që rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të drejtave të ankuesit sipas nenit 13 të cilat i ngarkohen veprimeve dhe/ose mosveprimeve të EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të tij dhe që SHM duhej t'ua ofronte kopjen e këtij vendimi, për informim, prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse.

#### **Rasti nr: 2011-27 F dhe të tjerët kundër EULEX**

##### **FAKTET**

Ky rast është parashtruar në Panel nga familja e X.F. X. F. ishte dëshmitar i prokurorisë në një lëndë të rëndë penale. Pas një numri të atentateve ndaj tij nga persona të panjohur, X.F., F. dhe fëmijët e tyre ishin pranuar në Programin për Sigurinë e Dëshmitarëve të EULEX-it (PSD). Kushtet e qëndrimit në PSD atyre u ishin dukur shumë të vështira dhe ishin larguar vullnetarisht nga ky program. Megjithatë, pasi që X. F. ende dëshironte të jepte dëshmi lidhur me këtë rast, ai ishte zhvendosur në njërin prej shteteve të BE-së.

X. F. ishte kthyer në Kosovë për të dhënë deklaratë në seancën paraprake në këtë rast. Më pas ai ishte ripranuar në PSD. Menjëherë pas kësaj ai ishte kthyer në shtetin anëtar të BE-së shoqëruar nga EULEX-i. Më 28 shtator 2011 X. F. kishte vdekur atje. Një hetim i kryer nga policia vendore kishte përcaktuar se ai kishte kryer vetëvrasje.

##### **ANKESAT**

Ankuesit pohojnë se presioni psikologjik të cilit i ishte nënshtruar X.F., trajtimi i tij nga EULEX-i dhe izolimi i tij nga familja e kishin çuar atë në kryerjen e vetëvrasjes. Ata pretendojnë se EULEX-i ishte

në dijëni për gjendjen e tij mendore të brishtë, por nuk ndërmori hapat e duhur për ta parandaluar vdekjen e tij.

## **PRANUESHMËRIA**

Paneli e ka shpallur ankesën të pranueshme më 13 qershor 2017 pasi që ka konsideruar që, ankesa ka ngritur çështje serioze të fakteve dhe të ligjit sipas Nenit 2 dhe 3 të Konventës. Mirëpo, ai ka konstatuar se ankesat lidhur me pjesëmarrjen e familjes F. në PSD ishin të papranueshme pasi që ishin jashtë afatit gjashtëmuor të paraparë me Rregullën 25 (3) të Rregullores së tij të Punës (RRP).

Po ashtu, Paneli ka vendosur që ankuesit të mos ia zbulojë parashtrimet e plota të EULEX-it mbi bazën e asaj se: *“publikimi do të mund të ndikonte negativisht në efektivitetin operacional të këtij Misioni apo në sigurinë e personelit të këtij Misioni”*. Paneli është bindur se kjo procedurë e ndjekur e ka ruajtur ekuilibrin e duhur midis të drejtës procedurale të ankuesve për të argumentuar në mënyrë efektive rastin e tyre, si për zgjidhjen efektive në Panel dhe me nevojën për të ruajtur konfidencialitetin e disa aspekteve të operimit të EULEX-it në fushën e ndjeshme siç është mbrojtja e dëshmitarëve.

## **LIGJI**

### **NENI 2 i Konventës**

*E drejta për hetime adekuate, efektive dhe të menjëhershme; përfshirja e familjes së të ndjerit*

Paneli ka ripërsëritur se neni 2 i Konventës e obligon gjithashtu shtetin që të kryejë hetime efektive për shkeljet e pretenduara të pjesës substanciale të saj. Këto standarde, në parim, janë pranuar nga Paneli të zbatueshme për EULEX-in, (shih, p.sh., [Sadiku-Syla kundër EULEX](#), 2014-34, para. 36; [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX](#), 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për Pranueshmërinë). Në mënyrë që të jenë “efektive”, hetimet duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë faktet dhe, sipas mundësisë, identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës (shih [KEDNJ, Ramsahai dhe tjerët kundër Holandës \[GC\]](#), Nr. 52391/99, § 324, ECHR 2007-II).

Paneli ka ripërsëritur se Misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se mundësia e tij për të garantuar mbrojtje efektive të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për jetën, nuk mund të krahasohet me atë të një shteti (shih [A, B, C dhe D kundër EULEX](#), 2012-09 – 2012-12, 20 qershor 2012, par. 50). Megjithatë, nëse vdes një dëshmitar i rëndësishëm i ndonjë rasti penal që ndiqet penalisht nga një prokuror i EULEX-it, atëherë një hetim i menjëhershëm nga EULEX-i për të përcaktuar rrjedhën e ngjarjeve me përfshirjen e duhur të familjes së të ndjerit do të ishte standardi minimal procedural sipas nenit 2.

*Obligimet thelbësore dhe procedurale sipas nenit 2*

Për sa i përket kritereve thelbësorë të nenit 2, Paneli ka theksuar se, nuk ishte argumentuar se X.F. kishte vdekur si rezultat i ndonjë veprimi kriminal ose si rezultat i përdorimit të kundërligjshëm apo të tepruar të dhunës nga ndonjë autoritet publik. Përfundimi i hetimeve penale të kryera nga policia vendore se X. F. kishte kryer vetëvrasje, nuk ishte kundërshtuar në asnjë mënyrë, si dhe nuk është treguar që i mungon besueshmëria.

Në anën tjetër, Paneli ka theksuar se EULEX-i nuk ka vepruar me kujdesin e duhur në rrethanat e ndjeshme të këtij rasti. Në veçanti, nuk është treguar se EULEX-i e kishte shqyrtuar me kujdes nëse veprimet e tij në lidhje me X. F. ishin në përputhje me kuadrin ligjor të mandatit ekzekutiv të tij.

Në lidhje me këtë, Paneli ka ripërsëritur se neni 2 i Konventës i imponon disa obligime të caktuara pozitive autoriteteve publike në lidhje me mbrojtjen e jetëve të personave të rrezikuar që ndodhen nën kujdesin e shtetit apo në përgjegjësinë e shtetit, si të paraburgosurit ose pacientët e institucioneve mjekësore të mbyllura. Megjithatë, kjo dispozitë nuk e garanton, *vetvetiu*, të drejtën për mbrojtje efektive nga vetëvrasja e ndonjë personi që është i lirë; aq më pak në situatën si në këtë rast, konkretisht të një personeli që ndodhej jashtë Kosovës, me çka edhe jashtë kontaktit me EULEX-in.

Prandaj, Paneli ka konkluduar se nuk ka pasur shkelje të Nenit 2 sipas pjesës substantive të tij.

Megjithatë, Paneli ka shqyrtuar po ashtu nëse EULEX-i i kishte përmbushur obligimet procedurale të tij sipas nenit 2. Ai ka konkluduar se EULEX-i nuk ka nisur hetime për t'i përcaktuar faktet dhe, ndoshta, ta përcaktojë përgjegjësinë e vet, e cila ka mundur të paraqitet pas vdekjes së X. F. Paneli ka theksuar se EULEX-i vetëm e ka bërë një shqyrtim pas një periudhe të konsiderueshme kohore pas vdekjes së X. F. ndërsa familja F. nuk është informuar për këtë shqyrtim, e as nuk ishte përfshirë në të.

Paneli ka konstatuar se me anë të kësaj është bërë shkelja e pjesës procedurale të Nenit 2.

### **Neni 3 i Konventës**

Paneli ka ripërsëritur se kjo dispozitë, për aq sa e ndalon trajtimin çnjerëzor ose poshtëruës, mund të shkilet nga autoritetet publike edhe në mungesë të ndonjë shkelje të integritetit fizik të atij personi si në rastin F. (p.sh. GJEDNJ, Valasinas kundër Lituanisë, Nr. 44558/98, 24 korrik 2001, Khamila Isayeva kundër Rusisë, Nr. 6846/02, 15 nëntor 2007).

Paneli ka theksuar se X.F. ishte dëshmitar në një rast të rëndë penal. Rreziqet të cilat i kishte kjo situatë për të ishin mjaft të qarta, për shembull, ndaj tij ishin bërë disa atentate. Për më shumë, pjesëmarrja e familjes në PSD ishte e vështirë pasi që ata ndjeheshin të izoluar dhe se jeta e tyre e përditshme ishte çrregulluar. Prandaj, Paneli ka konkluduar se X. F. ndodhej në një stres të rëndë për një periudhë të konsiderueshme kohore, derisa ishte në PSD dhe më pas, për shkak të brengosjes së tij për sigurinë dhe mirëqenien e familjes së tij si dhe për vetë jetën e tij.

#### *Obligimi për ta bërë vlerësimin e rrezikut – shkelja e integritetit fizik*

Paneli ka theksuar se nuk është dëshmuar se ishin bërë përpjekje adekuate për ta bërë vlerësimin e rrezikut për sigurinë dhe mirëqenien e X. F. dhe familjes së tij apo që X. F. ishte informuar lidhur me rreziqet potenciale që mund t'i kanoseshin atyre për shkak të vendimit për ta dërguar atë jashtë vendit.

Për më shumë, Paneli nuk është bindur nëse ishin krijuar aranzhime të veçanta të sigurisë apo ndonjë ndihmë ose mjete tjera (përveç "një sasi të caktuar të parave") për ta siguruar sigurinë dhe mirëqenien e X. F. deri sa ai do të jetonte jashtë shtetit. Gjithashtu, nuk është dëshmuar nëse ishte ndërmarrë ndonjë hap për ta ofruar dhe adresuar sigurinë dhe mirëqenien e familjes së tij që kishte mbetur në Kosovë. Prandaj, X. F. përgjatë një kohe ishte ballafaquar me një klimë të frikës, pasigurisë dhe ankthit në lidhje me sigurinë e tij dhe atë të familjes së tij, e që ka rezultuar me rrezikshmërinë e atypëratyshme të tyre.

Paneli ka konkluduar se veprimet ose mosveprimet e EULEX-it ishin shumë të rëndësishme për gjendjen e përgjithshme të mirëqenies së X. F. dhe të familjes së tij. Ai nuk është i bindur se ishte bërë shqyrtimi i mjaftueshëm i sigurisë dhe mirëqenies së tyre nga ana e EULEX-it.

Prandaj, Paneli ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës për aq sa ajo e ndalon trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues.

Po ashtu, Paneli i ka bërë rekomandime SHM-së që:

- të bëjë një deklaratë se e pranon që rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të drejtave të ankuesit të cilat i ngarkohen veprimeve dhe lëshimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të tij;
- t'iu shpërndajë vendimin personelit të këtij Misioni, detyrat e të cilëve kishte të bënte me lëndën e tij me qëllim të ofrimit të udhëzimeve lidhur me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut.

### **4.3. Vendimet për pranueshmërinë**

*Seanca e Panelit prej 9 deri 11 janar 2017*

Në lëndën nr. [2014-10 Nikollë Sokoli kundër EULEX-it](#) dhe në rastin Nr. [2015-04 Nazmi Maloku kundër EULEX-it](#) Paneli ka konstatuar se të dyja ankesat ishin të papranueshme në përputhje me Rregullat 25(3) dhe 29 (1) si dhe me Rregullën 29 (1)(c), (d), përkatësisht Rregullën 25(3) të Rregullores së Punës (RrP).

*Seanca e Panelit prej 6 deri 8 mars 2017*

Më 7 mars 2017, Paneli ka konstatuar se lëndët në vijim ishin të papranueshme në mënyra të ndryshme sipas Rregullës 29 (d) dhe Rregullës 29 (e); Rregullës 25 (1); Rregullës 29 (1) (c) dhe (e) dhe Rregullës 25 (3) të RrP-së: [2014-35 M.N. kundër EULEX-it](#); [2015-06 X. C. kundër EULEX-it](#); [2015-11 Zvonimir Jovanović kundër EULEX-it](#); [2015-12 U. kundër EULEX-it](#); [2015-15 Đorđe Šmigić kundër EULEX-it](#); [2016-01 Skender Jashari kundër EULEX-it](#); [2016-02 kundër EULEX-it](#); [2016-04 Valon Jashari kundër EULEX-it](#) dhe [2015-05 Teresa Peters kundër EULEX-it](#).

*Seanca e Panelit prej 12 deri 14 qershor 2017*

Më 13 qershor 2017, në rastin Nr. 2015-02, Ramadan Hamza kundër EULEX-it, Paneli ka konstatuar se ankesa ishte e papranueshme në përputhje me Rregullën 25 (1) të rregullores së tij të Punës si dhe me OPLAN-in e EULEX-i Kosovë pasi që ajo kishte të bënte me shkeljet e pretenduara të drejtave të tij në kontekstin e procedurave gjyqësore në gjykatat kosovare për të cilat Paneli nuk ka juridiksion.

*Seanca e Panelit prej 16 deri 18 tetor 2017*

Më 17 tetor, 2017 Paneli ka konstatuar se rastet nr. [2016-06 dhe 2017-04, Shpresim Uka kundër EULEX-it](#) ishin të papranueshme për shkak se nuk ishin në kuadër të juridiksionit të tij sipas nenit 29(a) dhe se ato nuk i ishin përmbajtur rregullave përkitazi me afatet kohore për parashtrimin e ankesës sipas nenit 25(3), Rregullorja e Punës, (RrP).

Po ashtu, më 17 tetor 2017, Paneli ka konstatuar se rasti Nr. [2016-07, Mentor Qela kundër EULEX-it](#) ishte e papranueshme sepse ankesa ishte parashtruar jashtë afatit kohor, neni 29(3); ishte jashtë juridiksionit të Panelit, neni 29(d) dhe se ishte qartazi e pabazuar, neni 29(e), RrP.

Më tutje, më 17 tetor 2017, Paneli ka konstatuar se lënda nr. [2016-08](#), Hamdi Hasani kundër EULEX-it; [2016-25](#), Hilmi Krasniqi kundër EULEX-it; [2016-26](#), T.G. kundër EULEX-it; [2016-27](#) Afrim

Islami kundër EULEX-it; [2016-33](#), Agron Bytyçi kundër EULEX-it; [2016-36](#), Namon Statovci kundër EULEX-it dhe [2017-03](#), Alfred Bobaj kundër EULEX-it ishin jashtë kompetencës së Panelit për shkak se ky Panel nuk i shqyrton procedurat gjyqësore të zhvilluara nga gjykatat kosovare, Rregulla 25 (1) dhe se ai nuk kishte kompetencë që t'i shqyrtoj këto ankesa sipas nenit 29(d), RrP.

#### **4.4 Vendimet për zbatimin e rekomandimeve të Panelit**

*Seanca e Panelit prej 9 deri 11 janar, 2017*

Paneli ka nxjerrë një (1) vendim të dytë për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të tij nga ana e shefes së Misionit, (SHM) në lëndën nr. [2011-20 X dhe 115 ankuesit tjerë kundër EULEX-it](#) dhe dy (2) vendime në lëndën nr. [2014-18 Fitim Maksutaj kundër EULEX-it](#) dhe në lëndën nr. [2014-37 Y.B. kundër EULEX-it](#) për zbatimin e rekomandimeve të tij nga ana e SHM-së si në vijim:

##### **Lënda nr. [2011-20 X dhe 115 ankuesit tjerë kundër EULEX-it](#)**

Në lidhje me vendimin e dytë pasues, në rastin nr. [2011-20 X dhe 115 ankuesit tjerë kundër EULEX-it](#), ("rasti Roma"), Paneli ka konstatuar se SHM-ja nuk i është përmbajtur rekomandimeve të tij në Vendimin e tij të datës 22 prill 2015 dhe i ka bërë thirrje SHM-së që ta njoftojë Panelin lidhur me progresin e mëtejme për këtë çështje deri në datën 28 shkurt 2017.

Paneli ka konstatuar në vendim se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës, e drejta për zgjidhje efektive dhe pas kësaj i ka bërë këto rekomandime:

SHM-ja duhet t'i udhëzojë zyrtarët e prokurorisë të EULEX-it që të bëjnë kërkesa tek autoritetet e Kosovës përkitazi me atë nëse për këtë çështje janë duke vazhduar hetimet dhe, nëse po, në cilën fazë ndodhet çështja.

Pas pranimit të atij informacioni, SHM-ja duhet t'i udhëzojë prokurorët e EULEX-it që të shqyrtojnë nëse duhet ta marrin përsipër përgjegjësinë për këtë rast në pajtim me Nenin 7 (A) të Ligjit Nr.04 / L-273 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit lidhur me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Paneli e ka nxjerrë vendimin për Zbatimin e Rekomandimeve të Panelit më 11 nëntor 2015 ndërsa Vendimin e tij të dytë pasues e ka nxjerrë më 10 janar 2017. SHM-ja i është përgjigjur Panelit më 16 mars 2017 në lidhje me Vendimin e Dytë të tij si në vijim: e ka informuar Panelin se kryeprokurori i EULEX-it (KPE) i kishte shkruar kryeprokurorit të shtetit (KPSH) më 6 shkurt 2017 për t'ia përkujtuar KPSH-së rekomandimet që i përmbante vendimi i Panelit. KPE e ka këshilluar KPSH-në se, në bazë të rrethanave të këtij rasti, nuk duhet të aplikohet afati i parashkrimit dhe se duhej shqyrtuar nëse duhej bërë hetime të mëtejme për të përcaktuar nëse ishte kryer vepra penale. Po ashtu, ishte sugjeruar se mund të parashtrohej kërkesa për heqjen e imunitetit në UNMIK mbi dokumentet përkitazi me këtë rast.

SHM-ja ka shtuar se KPSH e kishte informuar KPE më 28 shkurt 2017 se vendimi për ndërprerjen e hetimeve pritej të nxirrej së shpejti për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit që vlente për veprën penale të "shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm". Gjithashtu, SHM-ja ka informuar Panelin se ajo do ta shqyrtonte këtë vendim pasi ta merrte atë dhe më pas do të vendoste për hapat e mëtejme, nëse do të kishte të tillë, të cilët EULEX-i do të mund t'i ndërmernte në bazë të këtyre rrethanave.

Paneli aktualisht është në pritje të informatave tjera procedurale lidhur me ecurinë e hetimeve.

**Lënda nr. [2014-18 Fitim Maksutaj kundër EULEX-it](#)**

Në lëndën nr. 2014-18 Fitim Maksutaj, më 12 nëntor 2015, Paneli ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 6(1) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Ai, gjithashtu, i ka rekomanduar ShM-së që ta bëjë një deklaratë se e pranon që rrethanat e rastit përbënin shkelje të drejtave të ankuesit dhe t'i ndërmerr masat e nevojshme për ta shqyrtuar se çfarë hapash mund të ndërmerren nga Zyra e Kryeprokurorit të EULEX-it (ZKPE) për të siguruar që lëndët nën autoritetin e kësaj zyre të trajtohen në përputhje me dispozitat e nenit 6(1) të Konventës. Gjithashtu, ShM-ja duhet të sigurojë se ekziston një mekanizëm efektiv shqyrtues ashtu që të gjitha këto raste të trajtohen brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Paneli e ka miratuar Vendimin e tij për Zbatimin e Rekomandimeve të tij më 11 janar 2017. Ai i ka marrë parasysh hapat e ndërmarrë nga ShM-ja për t'i zbatuar rekomandimet e tij. Në veçanti ka theksuar se, ky Mision ishte duke e shqyrtuar mënyrën më të mirë për të krijuar standarde efektive për shqyrtimin e rasteve të trajtuara nga prokurorët e EULEX-it. Më tej, Paneli ka theksuar se ShM-ja nuk ka bërë asnjë deklaratë, në çfarëdo forme, për ta pranuar se rrethanat e rastit përbënin shkelje të drejtave të ankuesit që i ngarkohen veprimeve të EULEX-i Kosovë.

**Lënda nr. [2014-37 Y.B. Against EULEX-it](#)**

Në lëndën nr. 2014-37 Y.B. kundër EULEX-it, Paneli ka konstatuar më 19 tetor 2016 se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës. Ai, gjithashtu, i ka rekomanduar ShM-në që ta bëjë një deklaratë ku e pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të drejtave të ankuesit që i ngarkohen veprimeve ose mosveprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të tij. ShM-ja duhet t'ia ofroj nga një kopje të këtij vendimi prokurorëve të EULEX-it për t'i informuar prokurorët e EULEX-it rreth natyrës së përgjithshme të obligimit për ta bërë prioritet të tyre që t'i mbrojnë të drejtat dhe liritë jo vetëm të dyshuarve dhe të akuzuarve, por edhe të personave tjerë të përfshirë në rastet të cilat i hetojnë ata.

Paneli e ka miratuar vendimin e tij për zbatimin e rekomandimeve të tij më 10 janar 2017. Ai i ka marrë parasysh hapat e ndërmarrë nga ShM-ja për t'i zbatuar rekomandimet e tij. Megjithatë, Paneli ka vlerësuar se ShM-ja nuk ka bërë deklaratë, të çfarëdo forme, për ta pranuar se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it.

*Seanca e Panelit prej 6-8 mars 2017*

**Lënda nr. [2014-11 to 2014-17, D.W.; E.V.; F.U.; G.T.; Zlata Veselinovic; H.S. dhe I.R. kundër EULEX-it](#)**

Më 19 tetor, Paneli ka konstatuar në vendimin e tij për bazueshmërinë e lëndës se ka pasur shkelje të neneve 2 dhe 3, dhe nenit 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës në lëndën nr. [2014-11 to 2014-17, D.W.; E.V.; F.U.; G.T.; Zlata Veselinovic; H.S. dhe I.R. kundër EULEX-it](#).

Paneli i ka rekomanduar ShM-së që ta bëjë një deklaratë se e pranon që rrethanat e këtij rasti kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses, që t'ua komunikoj dhe transmetoj këtë vendim të gjitha autoriteteve përkatëse hetimore dhe prokuroriale të EULEX-it, që EULEX-i të komunikoj me të afërmit e viktimave në mënyrë të shpejtë dhe të kujdesshme, dhe gjithashtu t'i zbatoj udhëzimet për këtë lloj komunikimi. Po ashtu, ShM-ja ishte ftuar që zyrtarëve të misionit t'ua theksonte rëndësinë për rastet e zhdukjeve të dhunshme, të cilat duhet të jenë prioritet hetimor për EULEX-in

dhe se autoriteteve hetimore të EULEX-it duhej siguruar mjetet e nevojshme për ta përmbushur misionin e tyre për mbrojtjen posaçërisht të të drejtave të garantuara sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës.

Më tej ShM-së i ishte bërë thirrje që t'ua tërheq vëmendjen autoriteteve përkatëse hetimore dhe prokuroriale të EULEX-it për faktorët e cekur në këtë vendim, të cilët janë të rëndësishëm në vlerësimin e kompetencës së "jashtëzakonshme" të prokurorëve të EULEX-it në bazë të Nenit 7(A) të Ligjit të rishikuar për juridiksionin.

ShM-ja e ka informuar Panelin më 29 nëntor 2016 se ajo do t'ua komunikonte këtë vendim organeve përkatëse hetimore dhe prokuroriale të EULEX-it.

Në vendimin e tij për zbatimin e rekomandimeve të tij, më 7 mars 2017, Paneli ka deklaruar se ShM-ja i kishte zbatuar vetëm pjesërisht rekomandimet e tij dhe e kishte përshëndetur zotimin e S-M-së që t'i ofroj Panelit rezultatet e shqyrtimit të brendshëm të procedurave dhe udhëzimeve përkatëse në fuqi në kuadër të këtij Misioni.

#### **Lënda nr. 2014-32 L.O kundër EULEX-it**

Në vendimin e tij të datës 11 nëntor 2015, Paneli ka konstatuar se EULEX-i Kosovë kishte bërë shkelje të neneve 2 dhe 3 (pjesët procedurale) dhe nenet 8 dhe 13 të Konventës. Ai i kishte bërë thirrje ShM-së që ta bëjë një deklaratë se e pranon që rrethanat e këtij rasti kanë përbërë shkelje të drejtave të ankuesit, ta udhëzojë EULEX-in që të komunikojë me viktimat e pretenduara dhe të afërmit e tyre në mënyrë të shpejtë dhe të kujdesshme, ta shqyrtojë miratimin e udhëzimeve të cilat e përcaktojnë më hollësisht se çfarë mund të nënkuptojë ky udhëzim i përgjithshëm për rrethanat konkrete, të sigurojë që organet hetimore të EULEX-it (Task Forca Hetimore Speciale (TFHS) dhe prokurorët e EULEX-it) t'i kenë në dispozicion mjetet dhe mbështetjen të cilat janë të nevojshme për ta përmbushur misionin e tyre.

ShM-ja duhet të përpiqet që ta sqarojë marrëdhënien ndërmjet Misionit dhe TFHS-së për të siguruar mbrojtjen efektive të drejtave dhe garancive, ankuesve t'u ofrohet informacioni i duhur dhe i mjaftueshëm, t'ia bëjë të ditur TFHS-në dhe shteteve anëtare të BE-së rëndësinë e hetimit të plotë dhe efektiv të këtyre rasteve dhe t'ia bëjë të ditur TFHS-së rëndësinë dhe nevojën për t'i informuar viktimat lidhur me ecurinë e hetimeve të tyre.

Në vendimin pasues të tij për zbatimin e rekomandimeve të tij të datës 19 tetor 2016, Paneli ka theksuar se përgjegjësia për zbatimin dhe përmbushjen e rekomandimeve të Panelit bie tërësisht dhe ekskluzivisht mbi ShM-në, e jo mbi KKPOC apo shtetet anëtare. Në këtë kuptim, përderisa shefi i Misionit mund të vendosë në ndonjë rast të veçantë që të kërkojë ndihmën e të tjerëve për t'i zbatuar rekomandimet e Panelit, përfundimisht përgjegjësia për zbatimin e tyre mbetet mbi ShM-në. Paneli ka deklaruar se ShM-ja në largim nuk i kishte zbatuar rekomandimet dhe i kishte bërë thirrje SHM të ri që t'i shqyrtojë dhe zbatojë plotësisht secilin prej rekomandimeve të Panelit.

Më 8 dhjetor 2016, ShM-ja i ri i është përgjigjur vendimit të Panelit për zbatimin e rekomandimeve të tij të datës 19 tetor 2016.

Prandaj, më 7 mars 2017, Paneli e ka nxjerrë vendimin e dytë të tij për zbatimin e rekomandimeve të Panelit. Ai me keqardhje ka theksuar se kjo ka qenë praktikë e vazhdueshme e EULEX-it që të refuzojë apo mos ta pranojë formalisht përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesit, aty ku Paneli ka konstatuar se kjo kishte ndodhur.



Në lidhje me rekomandimin e tij të dytë për komunikimet me ankuesin, Paneli me kënaqësi e ka theksuar nismën e ShM-së për ta themeluar një Rrjet për Pikë të Kontaktit për të Drejtat e Njeriut për ta siguruar respektimin e të drejtave të njeriut nga EULEX-i.

Lidhur me pjesën tjetër të rekomandimeve të Panelit, ShM-ja ka thënë si në vijim:

“ ... po ju sjell në vëmendje përgjigjen e paraardhësit tim të datës 29 prill 2016 dhe nuk shoh ndonjë arsye për t’u larguar nga pikëpamja e shprehur aty. Kjo është mbështetur nga Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit 2014/685/CFSP të datës 19 shtator 2014 dhe Vendimin e Këshillit 2016/947/CFSP të datës 14 qershor 2016, të cilat përcaktojnë se EULEX-i do t’i mbështesë procedurat e zhvendosura gjyqësore brenda shteteve anëtare. Megjithatë, shtetet anëtare e kanë miratuar themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (DHS & ZPS) që janë plotësisht të pavarura nga EULEX-i. Ligji nr. 05/L-053 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015, përcakton se ZPS do ta merr përsipër mandatin dhe personelin e TFHS dhe “do të jetë zyrë e pavarur për hetimin dhe ndjekjen e krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara”. Përveç kësaj, shtetet anëtare kanë vendosur që DHS dhe ZPS do t’i përgjigjen një Ombudspersoni të veçantë dhe në mënyrë specifike përjashtohen edhe DHS dhe ZPS nga juridiksioni i këtij Paneli. Prandaj, nuk mund të ushtrohet presion mbi ZPS dhe DHS nga EULEX-i siç sugjerohet në rekomandim. Për këtë arsye nuk jam në gjendje t’i zbatoj këto rekomandime të Panelit”.

Paneli e ka marrë parasysh qëndrimin e ShM-së se ajo nuk është kompetente dhe nuk ka autoritet për t’i parashtruar dhe adresuar rekomandimet e Panelit në TFHS, DHS, ZPS apo shtetet që e mbështesin këtë institucion të ri. Bazuar në shqyrtimet e mësipërme, Paneli ishte i bindur që ShM-ja i kishte trajtuar në mënyrë të mjaftueshme rekomandimet e tij dhe kishte ofruar përgjigje adekuate për shumicën e këtyre rekomandimeve.

Më tej, Paneli ka deklaruar se ShM-ja i mëparshëm i kishte zbatuar rekomandimet e tij për këtë lëndë vetëm pjesërisht, dhe e kishte mirëpritur angazhimin e ShM-së së ri për ta njoftuar Panelin lidhur me rezultatin e shqyrtimit të brendshëm, si dhe kishte vendosur që ta mbyllte shqyrtimin e kësaj lënde.

#### Lënda nr. [2014-34 Rejhane Sadiku Syla kundër EULEX-it](#)

Më 19 tetor 2016, Paneli në këtë rast ka konstatuar se EULEX-i Kosovë kishte shkelur Nenet 2 dhe 3 dhe nenin 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës, dhe i kishte bërë rekomandimet si në vijim:

ShM-ja duhet ta bëjë një deklaratë që e pranon se rrethanat e këtij rasti kanë përbërë shkelje të drejtave të ankuesit, që t’ua komunikojë dhe transmetojë këtë vendim të gjitha autoriteteve përkatëse hetimore dhe prokuroriale të Misionit, që Misioni të komunikojë me të afërmit e viktimave në mënyrë të shpejtë dhe të kujdesshme dhe t’i miratojë udhëzimet për këtë komunikim. Po ashtu, ShM-ja duhet të theksojë rëndësinë për rastet e zhdukjeve të dhunshme, të cilat duhet të vazhdojnë të jenë prioritet hetimor dhe duhet të sigurohet që autoritetet hetimore të EULEX-it t’i kenë mjetet e nevojshme për ta përmbushur misionin e tyre.

Më tej ShM-së i ishte bërë thirrje që t’ua tërheq vëmendjen autoriteteve përkatëse hetimore dhe prokuroriale të EULEX-it për faktorët e cekur në këtë Vendim të cilët janë të rëndësishëm në vlerësimin e kompetencës së “jashtëzakonshme” të prokurorëve të EULEX-it në bazë të Nenit 7(A) të Ligjit të rishikuar për juridiksionin dhe për t’ua bërë të ditur atyre rëndësinë e marrjes parasysh të këtyre faktorëve gjatë vlerësimit të tyre nëse duhet ose jo që ata të kërkojnë të marrin përsipër

përgjegjësinë mbi këtë lëndë. ShM-ja ishte ftuar që të informonte Panelin lidhur me masat, të cilat i kishte ndërmarrë ajo në lidhje me këtë vendim deri më 19 nëntor 2016.

ShM-ja në letrën e saj të datës 28 nëntor 2016 ka thënë si në vijim:

“Një kopje e vendimit të Panelit i është dhënë prokurorëve të EULEX-it. Përveç kësaj, unë e kam miratuar themelimin e një Rrjeti për Pikë të Kontaktit për të Drejtat e Njeriut për të siguruar zbatueshmërinë e të drejtave të njeriut nga ana e Sektorëve. Një shqyrtim i brendshëm i procedurave dhe udhëzimeve që janë tani në fuqi do të jenë pjesë e këtij procesi dhe unë do ta informoj Panelin lidhur me rezultatet e këtij shqyrtimi të brendshëm.

Disa prej rekomandimeve të Panelit kanë të bëjnë me masat që janë në kompetencë të Planifikimit Civil dhe Aftësive të Udhëheqjes (‘PCAU’), disa institucioneve të BE-së, si dhe shteteve anëtare. Unë i kam informuar PCAU-në dhe shtetet kontribuese lidhur me vendimin dhe gjetjet e Panelit përmes komandantit të Operacioneve Civile. Më tej, dëshiroj të theksoj se prokurorët e EULEX-it janë gjithashtu në dijeni të rregullave dhe rregulloreve në fuqi sa i përket “rrethanave të jashtëzakonshme” të përcaktuara me nenin 7 (A) të Ligjit të ndryshuar mbi kompetencat.”

Më 7 mars 2017, Paneli ka marrë vendimin për zbatimin e rekomandimeve. Në lidhje me rekomandimin e tij të parë se rrethanat e këtij rasti përbënin shkelje të drejtave të ankueses, Paneli me keqardhje ka theksuar se kjo ka qenë praktikë e vazhdueshme e EULEX-it që të refuzojë apo mos ta pranojë formalisht përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesit, aty ku Paneli ka konstatuar se kjo kishte ndodhur.

Prandaj, Paneli ka deklaruar se ShM-ja i kishte zbatuar rekomandimet e tij për këtë lëndë vetëm pjesërisht, dhe e kishte mirëpritur angazhimin e ShM-së për ta njoftuar Panelin lidhur me rezultatin e shqyrtimit të brendshëm, si dhe kishte vendosur që ta mbyllte shqyrtimin e kësaj lënde.

*Seanca e Panelit prej 12 deri 14 qershor 2017*

Paneli ka marrë një (1) vendim për lëndën nr. 2013-21, Thomas Rusche kundër EULEX-it për zbatimin e rekomandimeve të tij nga ana e ShM-së.

#### **Lënda nr. [2013-21, Thomas Rusche kundër EULEX-it](#)**

Në vendimin e tij të datës 13 qershor 2017 për Zbatimin e Rekomandimeve të tij, Paneli ka deklaruar se ShM-ja i kishte zbatuar rekomandimet e tij në vendimin mbi bazueshmërinë e këtij rasti vetëm pjesërisht dhe kishte vendosur që ta mbyllte shqyrtimin e kësaj lënde.

Ky rast kishte të bënte me përvetësim të pretenduar prej ankuesit nga ana e palëve private dhe ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut, të cilat janë paraqitur si rezultat i angazhimeve të pamjaftueshme të EULEX-it për ta ndihmuar atë në ruajtjen e të drejtave të tij (shih faqe 8 sipër).

Paneli kishte konstatuar se EULEX-i i kishte shkelur të drejtat e ankuesit për zgjidhje efektive të garantuara përmes nenit 13 të Konventës. Duke i pasur parasysh këto gjetje të tij sipas nenit 13, Paneli ka vlerësuar se nuk ishte e nevojshme që të shqyrtohej ankesa sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

## **4.5 Lëndët e hequra nga lista**

*Seanca e prej 12 deri 14 qershor 2017.*

Në lëndën nr. [2015-14, Miodrag Konic kundër EULEX-it](#) dhe në lëndën nr. [2015-16, Vuleta Vostic kundër EULEX-it](#), Paneli ka vendosur që t'i heqë këto dy kërkesa nga lista e lëndëve më 13 qershor 2017 në përputhje me rregullën 29 e tutje paragrafi 1(1) i RrP-së. Në këto raste, Paneli nuk ishte në gjendje të ketë komunikim të duhur me ankuesit, të cilët në mënyrë të përsëritur nuk i janë përgjigjur letrave të Panelit.

#### **4.6 Publikimi i lëndëve të Panelit nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut - seksionet e praktikës gjyqësore të juridiksioneve të tjera:**

Vendimet e Panelit për zhdukjet e dhunshme në lëndën [D.V., E.V., G.T., Veselinovic., H.S. dhe I.R. kundër EULEX - nr. 2014-11 to 2014-17](#), dhe lëndën [Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it - nr. 2014-34](#) janë publikuar në Shkresën Informuese për Praktikën Gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në botimin gusht-shtator 2017.

[http://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=caselaw/analysis&c=#n1347528850996\\_pointer](http://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=caselaw/analysis&c=#n1347528850996_pointer)

Publikimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është reprodukuar më poshtë për ta bërë më të lehtë gjetjen e tij:

«Human Rights Review Panel/Groupe consultative sur les droits de l'homme  
Enforced disappearances in Kosovo/Disparations forcées au Kosovo

Case of D.V., E.V., G.T., Veselinovic, H.S and I.R. v. EULEX/Affaire D.V., E.V., G.T., Veselinovic, H.S et I.R. c. EULEX – Nos./Nos. 2014-11 to/à 2014/17 ; Case of Sadiku-Syla v. EULEX/Affaire Sadiku-Syla c. EULEX – No./No. 2014-34 Decisions on merits/Décisions sur le fond 19.10.2016.

Bashkimi Evropian e ka themeluar Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut më 29 tetor 2009 me mandat për shqyrtimin e ankesave për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i Kosovë (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë) gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij. Nëse ky Panel, i cili është organ i pavarur, përcakton se ka ndodhur ndonjë shkelje, gjetjet e tij mund të përfshijnë rekomandime jo të obligueshme për veprime korrigjuese nga ana e shefit të Misionit.

Gjatë nxjerrjes së konstatimeve, Paneli është i autorizuar që të aplikoj instrumentet e të drejtave të njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e këtij Paneli janë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Marrëveshja Ndërkombëtare e OKB për të Drejtat Civile dhe Politike (MNDPC).

Në vendimet dhe konstatimet e tij, Paneli në praktikën gjyqësore të vet vazhdimisht i ka përmendur standardet e Konventës të zhvilluara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. (Për më shumë informata lidhur me punën e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ju lutemi vizitoni faqen e internetit të tij dhe Raportin Vjetor të tij për vitin 2016).

Ky grup i lëndëve ka të bëjë me personat e vrarë dhe të pagjetur, të ashtuquajturat rastet e “zhdukjes së dhunshme”, të cilat kanë ndodhur si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë në gjysmën e dytë të vitit 1999 dhe në fillim të vitit 2000. Ankuesit janë ankuar se nuk janë bërë hetime të duhura penale për t'i vërtetuar faktet dhe pas kësaj nuk është bërë përcaktimi i përgjegjësisë së kryerësve të veprave.

Paneli i ka marrë parasysh standardet e zhvilluara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas nenit 2 të Konventës për aq sa kjo ia ka ngarkuar autoriteteve publike obligimin procedural

për t'i vërtetuar faktet lidhur me shkeljet e pretenduara të së drejtës për jetën. Ai e ka analizuar fushëveprimin e këtyre obligimeve në kontekstin e mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Ai ka konstatuar se përgjigja procedurale e pritur nga ky Mision duhet të jetë në përputhje me peshën e shkeljes së pretenduar dhe me rëndësinë e të drejtave të mbrojtura, por gjithashtu se fushëveprimi i obligimeve të këtij Misioni nuk mund të shkojë përtej natyrës së kufizuar, të cilën e dikton mandati ekzekutiv i tij.

Ai ka konstatuar se angazhimet hetimore të EULEX-it ishin të pamjaftueshme dhe kanë rezultuar në shkeljen e të drejtave të ankuesve të garantuara me anë të neneve 2 dhe 3 të Konventës në lidhje me dhe sipas nenit 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës.”

## **6. Aktivitetet e tjera të Panelit**

### **6.1 Takimet**

#### **Takimi me shefen e Misionit EULEX-i Kosovë më 7 mars 2017.**

Paneli është takuar me zj. Alexandra Papadopoulou, shefe e Misionit, e shoqëruar nga znj. Elaine A Paplos, znj. Marianne Fennema dhe znj. Valentina Vitali në ndërtesën e PShDNJ-së më 7 mars 2017. Agjenda e takimit përfshinte diskutimet lidhur me vëllimin aktual të punës së Panelit dhe ndikimin e tij në burimet e zvogëluara njerëzore të Sekretariatit pas ri-konfigurimit të personelit të EULEX-it në vitin 2016. Gjatë diskutimit u trajtuan edhe çështjet lidhur me personat e vrarë dhe të pagjetur, d.m.th. zhdukjet e dhunshme gjatë konfliktit të armatosur pas muajit qershor 1999. Po ashtu, janë diskutuar edhe temat e referencës së Rrjetit të propozuar për Pikë të Kontaktit për të Drejtat e Njeriut.

#### **Takimi me shefen e Zyrës Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut, EULEX-i Kosovë më 13 qershor 2017.**

Në agjendë ishin përfshirë, mes të tjerash, sfidat rreth burimeve njerëzore për Sekretariatit e Panelit në kontekstin e ri-konfigurimit të personelit; përqendrimin e çështjeve të të drejtave të njeriut dhe atyre gjinore në EULEX; mandatin ekzekutiv të EULEX-i kundrejt ndryshimeve në Ligjin nr. 03/L053 për Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë; Nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore në kontekstin e rasteve të personave të vrarë dhe të pagjetur; temat e referencës së Pikës së Kontaktit për të Drejtat e Njeriut në EULEX; drejtësia tranzicionale dhe çështjet që paraqiten në Panel në kontekst të ndërprerjes së aktiviteteve të këtij Misioni në një të ardhme të pacaktuar.

#### **Takimi me znj. Katja Dominik, shefe e Divizionit Ekzekutiv, EULEX-i Kosovë më 13 qershor 2017.**

Në agjendë ishin përfshirë, mes të tjerash, përfshirja e çështjeve të drejtave të njeriut në EULEX, drejtësia tranzicionale dhe çështjet që paraqiten në Panel në kontekst të ndërprerjes së paraparë të funksioneve të EULEX-it në një të ardhme të afërt.

#### **Takimi me shefen e Misionit EULEX-i Kosovë më 17 tetor 2017.**

Paneli ka mbajtur gjithashtu një takim me znj. Alexandra Papadopoulou, shefe e Misionit të EULEX-it gjatë seancës së fundit, të martën më 17 tetor 2017. Në diskutime u përfshinë çështje nga fusha e të drejtave të njeriut në Kosovë që paraqesin shqetësime dhe janë me interes të përbashkët si për EULEX-in ashtu edhe për Panelin.

## 6.2. Fushata informuese e vitit 2017

Dokumenti i Konceptit të Llogaridhënies i datës 29 tetor 2009, *ndër të tjera* në paragrafin E thekson se "... EULEX-i Kosovë do të sigurojë shpërndarje të duhur të informacionit publik rreth Panelit dhe punës së tij ...".

Komandanti i Operacioneve Civile, në udhëzimin e tij të datës 13 nëntor 2009 në lidhje me Panelin, ka deklaruar se Udhërrëfytyesi për Kapacitetet e Planifikimit dhe Operacioneve Civile duhet të përfshijë "...përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse të marrëdhënieve me publikun".

Fatkeqësisht, për shkak të mungesës së madhe të personelit në Sekretariat, gjatë periudhës raportuese nuk ka qenë e mundur që të realizohet plotësisht fushata për sensibilizimin e opinionit publik. Kjo edhe mund të jetë arsyeja për numrin e vogël prej shtatë (7) ankesave të cilat janë regjistruar gjatë vitit 2017. Ndërsa, dihet fakti se mjetet për zgjidhje efektive ligjore në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut si ato që i ofron ky Panel do të ishin efektive vetëm nëse ankuesit janë të vetëdijshëm për ekzistimin e tij dhe për natyrën e mandatit të tij.

Siç është thënë në Raportet Vjetore të mëparshme, vazhdon të ketë mungesë të përgjithshme të njohurive dhe informatave për Panelin, për mandatin dhe për punën e tij në gjithë hapësirën ku vepron Misioni i EULEX-it. Kjo kryesisht për shkak të pamundësisë së Sekretariatit, për arsye të resurseve, që të bëjë fushatë informuese të tipit të gjerë e cila është e nevojshme për ta adresuar këtë problem.

Në këtë kontekst, meqë Paneli tani ka arritur të ketë në dispozicion dy zyrtarë ligjorë, gjatë vitit 2018 do të ketë mundësi për më shumë aktivitete sensibilizuese. Vazhdimi i fushatës së reklamave në TV dhe radio do ta ndihmojë Panelin në këtë drejtim.

## 6.3. Trajnimi hyrës

Sekretariati e ka vazhduar pjesëmarrjen e tij në programin e trajnimit hyrës të EULEX-it për pjesëtarët e rinj të personelit të EULEX-it. Ky format përbëhet nga një prezantim për Panelin me një kohë të caktuar për pyetje dhe përgjigje. Ky proces është shumë i dobishëm për t'i informuar pjesëtarët e ardhshëm të personelit për mandatin e Panelit, për ta nënvizuar edhe më shumë rëndësinë e respektimit e të drejtave të njeriut për EULEX-in Kosovë, si dhe për ta ngritur rëndësinë e Panelit tek personeli i EULEX-it në zonën ku vepron misioni EULEX-i Kosovë.

Paneli e konsideron këtë si një element me rëndësi të veçantë për fushatën sensibilizuese dhe që kjo mënyrë i ofron Panelit një mundësi për të siguruar që të gjithë pjesëtarët e ri të personelit të EULEX të jenë të informuar lidhur me obligimin e tyre për t'i respektuar standardet përkatëse të drejtave të njeriut gjatë kryerjes së funksioneve të tyre, si dhe implikimeve në llogaridhënie në rastin e shkeljeve të mundshme të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve ekzekutive të tyre.

## 6.4. Faqja e internetit e PShDNj-së

Sekretariati e mirëmban faqen e internetit të Panelit: [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu). Kjo faqe përmban informata lidhur me mandatin, procedurat dhe punën e Panelit, si dhe informata rregullisht të përditësuara lidhur me vendimet e Panelit, si dhe listën e lëndëve që janë ende të pazgjidhura dhe ato të përfunduara.

Tabela e jurisprudencës së Panelit ofron qasje të lehtë në të. Aty paraqitet praktika gjyqësore në rritje e Panelit dhe e ndarë sipas lëndëve, në bazë të pranueshmërisë dhe përmbajtjes së rasteve në shqyrtim. Ajo është krijuar, mes tjerash, për të siguruar qasje të gatshme dhe të lehtë në praktikën gjyqësore të Panelit për ankuesit, juristët dhe për opinionin e gjerë: (<http://www.hrrp/jurisprudence.php>).

Faqja e internetit gjithashtu ofron informacione për:

Standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut: (<http://www.hrrp.eu/relevant-rights.php>);

Formularët dhe udhëzimet për parashtrimin e ankesave: (<http://hrrp.eu/filing%20complaints.php>);

Po ashtu, Paneli e ka profilin e tij në Facebook: Human Rights Review Panel;

Informatat e mësipërme janë në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

## **7. Emërimet gjyqësore në Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar**

Znj. Alexandra Papadopoulou, shefja e Misionit EULEX-i Kosovë, emëroi dy anëtarë aktualë dhe të mëparshëm të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it si dhe një ish-anëtarë të Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut si gjykatës në Dhomat e Specializuara në Hagë të Holandës më 7 shkurt 2017, (shih në vijim). Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar nr. 05 L/-053 është shpallë me Dekretin nr. DL-027-2015 më 3 gusht 2015. Dhomat e Specializuara dhe Prokuroria e Specializuar kanë juridiksion për krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimet e tjera sipas ligjeve të Kosovës në lidhje me pohimet e raportuara në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të datës 7 janar 2011 parimisht në lidhje me krimet e luftës të kryera nga ish-paramilitarët shqiptarë të Kosovës të UÇK-së, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (<https://www.scp-ks.org/en>)

### **Dr. Guénaél Mettraux**

Dr. Mettraux është emëruar gjykatës në Dhomat e Specializuara më 7 shkurt 2017. Ai është anëtar i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut që nga 30 shtatori 2012 (shih në vijim pjesën 8.1). Dr. Mettraux është nënshtetas i Zvicrës dhe posedon licence en droit nga Universiteti i Lozanës (Zvicër), magjistër i juridikut nga Kolegji Universitar në Londër dhe ka doktoruar për juridik në Shkollën londineze të ekonomisë dhe shkencave politike (London School of Economics and Political Science).

Ai ka punuar si avokat mbrojtës dhe konsulent në gjykatat penale ndërkombëtare (ICTY, ICC, STL dhe ECCC) gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit. Gjatë asaj kohe, ai ka përfaqësuar disa udhëheqës të lartë ushtarakë dhe civilë, të akuzuar për krime ndërkombëtare. Ai ka këshilluar qeveri dhe OJQ rreth çështjeve të ndryshme lidhur me regjimet rregullatore, gjykimet penale, ligjet dhe drejtësinë tranzicionale. Dr. Mettraux tani është profesor në Universitetin e Amsterdemit (Holandë) dhe ligjërues mysafir në Universitetin e Friburgut (Zvicër).

Dr. Mettraux ka bërë publikime të shumta në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Puna e tij shkencore përfshinë tri libra: *International Crimes and the ad hoc Tribunals (Krimet Ndërkombëtare dhe Tribunalet ad hoc)* (Oxford University Press, 2005), *Perspectives on the Nuremberg Trial (Perspektiva rreth Gjyimit të Nyrembergut)* (Oxford University Press, 2008) dhe *The Law of Command Responsibility (Ligji mbi përgjegjësinë komanduese)* (Oxford University Press, 2009), e

cila ka marrë çmimin Lieber nga American Society of International Law (Shoqata Amerikane e së Drejtës Ndërkombëtare). Dr. Mettraux-i është anëtar i Komisionit Redaktues të Revistës të së Drejtës Ndërkombëtare dhe i Këshillit Redaktues të Revistës të së Drejtës Penale Ndërkombëtare.

### **Gjykatësi Antonio Balsamo**

Gjykatësi Antonio Balsamo, nga Italia, është emëruar gjykatës ndërkombëtar në Dhomat e Specializuara në Hagë të Holandës më 7 shkurt 2017. Ai ka shërbyer si anëtarë kryesues i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i EULEX-it në Kosovë nga maji 2010 deri në maj 2012.

Ai ka shërbyer si zëvendësprokuror i përgjithshëm i Gjykatës Supreme të Kasacionit në Itali që nga viti 2016, dhe si profesor i së drejtës penale në Fakultetin Juridik të LUMSA në Palermo. Më parë ai ka shërbyer si kryetar i Gjykatës Penale të Caltanissetta nga viti 2011 deri në vitin 2016. Para kësaj, gjykatësi Balsamo ishte gjykatës i dërguar me punë në Gjykatën Supreme të Kasacionit të Italisë nga viti 2007 deri në vitin 2011 dhe gjykatës i Gjykatës së Palermos nga viti 1992 deri në vitin 2007.

Gjykatësi Balsamo ka marrë pjesë si ekspert dhe konsulent në projekte të BE-së në lidhje me reformimin e Kodit Penal të Bullgarisë, themelimin e Prokurorive publike për rastet e krimeve të organizuara dhe korrupsionit në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe për trafikimin e njerëzve në Turqi. Ai ka qenë anëtarë i një sërë komisionesh dhe këshillash gjyqësore të Italisë.

Gjykatësi Balsamo është i diplomuar nga Universiteti i Palermos (Itali), dhe ka specializuar në të drejtën e qeverisjes rajonale dhe lokale në Universitetin e Palermos. Ai është emëruar gjykatës praktikant në vitin 1991. Ai ka bërë shumë publikime për tema të ndryshme në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtën penale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

### **Gjykatësja Michele Picard**

Gjykatësja Michele Picard, nga Franca, po ashtu është emëruar gjykatëse ndërkombëtare në Dhomat e Specializuara në Hagë të Holandës më 7 shkurt 2017. Ajo ka shërbyer si anëtare e Panelit Këshillues të UNMIK-ut për të Drejtat e Njeriut nga janari 2007 deri në mars 2008.

Gjykatësja Picard ka shërbyer si gjykatëse në Gjykatën e Apelit të Parisit që nga qershori 2013. Më parë ajo ka shërbyer si gjykatëse në Tribunalin Ndërkombëtar Penal për Ish-Jugosllavinë nga viti 2008 deri në vitin 2013. Mes viteve 2007 dhe 2008, ajo ka shërbyer si anëtare e Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut dhe nga viti 1996 deri 2003 ka qenë kryesuese e Dhomës për të Drejtat e Njeriut për Bosnjën dhe Hercegovinën. Në vitin 2005, ajo u emërua eksperte e pavarur për Situatën e të Drejtave të njeriut në Uzbekistan. Ajo gjithashtu ka punuar për Këshillin e Evropës si eksperte për projekte të përafrimit të legjislacionit vendor me atë evropian për të drejtat e njeriut në Maqedoni, Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Gjykatësja Picard është juriste e diplomuar nga Universiteti i Parisit II. Ajo ka diplomuar nga Shkolla Kombëtare për Gjykatës në Bordeaux në vitin 1992.

## 8. Paneli dhe Sekretariati

### 8.1. Anëtarët e Panelit

Sipas Konceptit të Llogaridhënies dhe Rregullores së Punës së Panelit, Paneli përbëhet prej katër anëtarëve; dy anëtarë të jashtëm, kryesuesja e Panelit dhe një anëtar i plotë dhe anëtar zëvendësues i Panelit. Dy të fundit janë gjykatës të EULEX-it.

#### Kryesuesja e Panelit

**Zj. Magda Mierzewska**, shtetase e Polonisë, ka mbaruar Provimin Shtetëror të Polonisë për poste gjyqësore në vitin 1982. Ajo u pranua në Odën e Këshilltarëve Juridik të Gdanskut në vitin 1989 dhe ka arritur shkallën e magjistratit të drejtësisë (LLM) në të Drejtën e Bashkimit Evropian në Universitetin Leicester në vitin 2005.

Ajo u emërua juriste rreth lëndëve në Sekretariatit e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në vitin 1993. Pastaj, nga viti 1998 ajo është punësuar si juriste dhe më vonë si kryesuese e Divizionit në Sekretariatit e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë. Ajo ka përvojë të gjerë ndërkombëtare të trajnimit në çështje të ndryshme thelbësore dhe procedurale të drejtave të njeriut.

Znj. Mierzewska është emëruar anëtare e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it nga ushtruesi i detyrës së shefit të Misionit të EULEX-it më 4 maj 2010. Ajo u zgjodh kryesuese e Panelit më 3 tetor 2012.

Publikimet e shumta akademike të znj. Mierzewska përfshijnë: *Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut: Dhjetë vite pas Ratifikimit*, Zyra për Informim e Këshillit të Evropës në Varshavë, 2004; *Dhjetë vjet më pas: Popullariteti i Konventës në Poloni* (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi i 4, 2004; *Dhjetë vjet më pas: Praktika gjyqësore polake voluminoze dhe interesante* (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi 5, 2004; *Standardet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet lidhur me shpronësimet dhe aplikimin e tyre për kërkesat pronësore gjermane*, Instituti Polak për Marrëdhënie ndërkombëtare, 2005; *Procesi i pranimi të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Poloni dhe Sllovaki në: Pranimi i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut*, botimet. H. Keller, A. Stone-Sweet, Oxford University Press, maj 2008; *Konsistenca e praktikës gjyqësore si çështje e të drejtave të njeriut në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në: Cohérence et impact de la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme*, Liber amicorum Vincent Berger, 2013. Ajo është bashkë autore me J. Krzyzanowski, *Według ojca, według córki* (Sipas babait, sipas vajzës), e cila ka marrë një çmim për librin më të mirë historik të botuar në Poloni në vitin 2010.

#### Anëtarët

##### **Prof. Dr. Guénaél Mettraux**

Shih pjesën 7 më lartë.



## **Znj. Elka Ermenkova**

Znj. Elka Filcheva-Ermenkova, shtetase e Bullgarisë ka studiuar për drejtësi në Universitetin e Blagoevgrad-it në Bullgari, ku ka diplomuar në vitin 1997. Pas përfundimit të praktikës pas-universitar, në tetor 1998 ajo është emëruar gjykatëse e re në Gjykatën e Qarkut në Blagoevgrad në një panel të ankimit, ku nën mbikëqyrjen e dy gjykatësve të Gjykatës së Qarkut ajo ka kryesuar lëndë në të gjitha fushat e të drejtës civile, penale dhe administrative. Në vitin 2001 ajo është emëruar gjykatëse në Gjykatën Rajonale në Blagoevgrad ku ka kryesuar çështjet civile dhe penale. Në vitin 2003 ajo është emëruar kryetare e Gjykatës Rajonale në Blagoevgrad.

Në vitin 2004, ajo është emëruar gjykatëse e Gjykatës së Qarkut në shkallën e parë dhe të dytë, ndërsa ka punuar edhe si gjykatëse e shkallës së parë dhe gjykatëse e apelit në çështjet civile dhe penale, me theks kryesor në çështjet civile. Si gjykatëse e apelit ajo ka gjykuar ankesat kundër aktgjykimeve të pesë gjykatave rajonale në fushën penale dhe civile. Në janar të vitit 2008, ajo është dërguar në Këshillin e Bashkimit Evropian (BE), në Komisionin për Kapacitetet e Planifikimit dhe Operacioneve Civile (KKPOC) si këshilltare për sundim të ligjit, ku ka punuar deri në janar të vitit 2012. Në këtë cilësi ajo e ka ndihmuar Sekretariatit e Këshillit (më vonë Shërbimi për Veprim të Jashtëm i Bashkimit Evropian (ShVJBE), për planifikimin dhe realizimin e misioneve civile për menaxhimin e krizave duke ofruar ekspertizën e saj në fushën e sundimit të ligjit.

Në janar të vitit 2012 ajo është punësuar nga EULEX-i Kosovë si gjykatëse ndërkombëtare në Panelin për Ankesa, për ankesat kundër vendimeve të Komisionit të Kosovës për Kërkesa Pronësore, ku ka vendosur për konteste pronësore lidhur me konfliktin e armatosur në Kosovë 1998/1999. Në gusht 2014 ajo u caktua gjykatëse ndërkombëtare e lëndëve penale në Gjykatën Supreme të Kosovës me mandat për lëndët penale që kanë të bëjnë me krimet e luftës, krimin e organizuar dhe krime të tjera të rënda.

Zj. Ermenkova është emëruar anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në janar të vitit 2013, ndërsa në nëntor të vitit 2016 ajo u emërua anëtare e Panelit nga EULEX-i. Ajo gjatë karrierës profesionale të saj ka fituar një përvojë të madhe dhe të gjerë në ligjet për të drejtat e njeriut, veçanërisht në të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën për liri, lirinë e të shprehurit, ndalimin e diskriminimit, dhe të drejtën në pronë.

## **Znj. Anna Bednarek**

Anna Bednarek u diplomua në Universitetin e Gdanskut, Poloni dhe fitoi titullin magjistër për juridik (LLM) në vitin 1994, kurse provimin shtetëror polak për pozita gjyqësore e kreu në vitin 1997. Studimet post-diplomë si gjykatëse e lëndëve civile i kreu në Akademinë e Shkencave të Polonisë, Varshavë, si dhe studimet post-diplomike në Institutin e Shkencave të Vendeve në Zhvillim në Universitetin e Varshavës në vitet 2008/2009. Zj. Bednarek ka punuar si Eksperte e Lartë në Zyrën e Përfaqësuesit të Qeverisë së Polonisë në Komisionin Evropian dhe Gjykatën për të Drejtat e Njeriut, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave Kombëtare, Departamenti Ligjor dhe i Traktateve në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Polonisë, Varshavë. Po ashtu, ajo ka qenë anëtare e Delegacionit të Qeverisë së Polonisë në Sesionin e 54-t për të Drejtat e Njeriut në Komisionin e Kombeve të Bashkuara.

Ajo u emërua gjykatëse në Gjykatën e Qarkut të Varshavës gjatë periudhës qershor 1998 dhe vitit 2001. Ajo pastaj ishte punësuar si konsull në Ambasadën e Polonisë, Romë, Itali prej vitit 2001 deri 2007. Ajo ka punuar gjykatëse në Gjykatën e Qarkut të Varshavës prej prillit 2007 deri në janar 2009. Pastaj ajo u emërua gjykatëse e EULEX-it në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ku ka punuar që nga

muaji shkurt 2009. Zj. Bednarek u emërua anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it nga shefi i Misionit EULEX-i Kosovë më 25 maj 2011 dhe u emërua anëtare zëvendësuese e Panelit nga shefi i Misionit EULEX-i Kosovë më 12 korrik 2011.

Pas kësaj, zj. Bednarek ka punuar si gjykatëse në Gjykatën e Qarkut të Varshavës janarit 2012 deri në shtator 2015. Ajo ka marrë pjesë si bashkë-autore dhe konsulente në një projekt të organizuar nga Fondacioni Helsinki në Poloni që kishte për qëllim publikimin e një Udhëzuesit për gjykatës dhe prokurorë me titull *“Trajtimi i barabartë i palëve në procedurë”* në vitin 2015. Ndërmjet shtatorit 2014 dhe qershorit 2015, zj. Bednarek ka bashkë-vepruar me Institutin e Evropës Qendrore dhe Lindore për Iniciativa Ligjore në Pragë, Republika e Çekisë, në një projekt me qëllim publikimin e *“Udhëzuesit gjyqësor për pavarësinë, paanësinë dhe integritetin e drejtësisë: Përmbledhje tematike e standardeve, politikave dhe praktikave më të mira ndërkombëtare”*.

Në prill të vitit 2015, ajo mori pjesë në projektin *“Gjykimi në shoqërinë demokratike”*, ku ajo ishte përfshirë si trajnuese e kryetarëve të gjykatave të Tunizisë për standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut. Gjatë viteve 2013 dhe 2014, me ftesë të IBAHRI ajo ligjëroi në trajnime për gjykatës të Tunizisë për temën e të drejtave të njeriut. Në tetor 2013, zj. Bednarek mori pjesë si fasilituese në një projekt të realizuar nga Fondacioni për Bashkëpunim Polako-Ukrainas (PAUCI) nga Varshava dhe ka mbajtur seminare në universitetet e Ukrainës (Lvov, Kharkov, Donetsk) në temën: *“Fuqizimi i funksionit të kontrollit të gjyqësorit si ekuilibër ndërmjet autoriteteve në Ukrainë”*.

Në vitin 2008 ajo mori pjesë si trajnuese e projektit *“Trafikimi i njerëzve – Trajnim për gjykatës”* i paraparë për ta luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe skllavërinë. Ky projekt ishte organizuar nga Fondacioni *“La Strada”*, Varshavë, Poloni në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Polonisë dhe me Ambasadën Britanike në Varshavë. Po ashtu, zj. Bednarek ka punuar për Amnesty International si menaxhere e projektit të një projekti në Poloni për publikimin e një Doracaku Arsimor për të Drejtat e Njeriut.

Znj. Bednarek është emëruar anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nga shefja e Misionit EULEX-i Kosovë më 14 tetor 2016. Shefja e Misionit e emëroi gjykatësen Bednarek anëtare të Panelit në dhjetor të vitit 2017.

## **Z. Jorge Martins Ribeiro**

Jorge Martins Ribeiro ka diplomuar në fakultetin juridik në qershor të vitit 1993 në Shkollën e Juridikut të Universitetit të Coimbra-s. Është regjistruar në Shkollën portugeze të gjykatësve dhe prokurorëve në Lisbonë në shtator 1994 ndërsa është gjykatës që nga maji i vitit 1996 dhe gjykatës i Gjykatës së Qarkut që nga shtatori i vitit 1999.

Ai ishte gjykatës i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnjës dhe Hercegovinës (O.H.R. - H.J.P.C.), i dërguar nga M.F.A dhe M.J. e Portugalisë, dhjetor 2002 dhe mars 2004. Ai ka përfunduar kursin bazë të Komisionit Evropian rreth Aspekteve Civile të Menaxhimit të Krizave në Qendrën Studimore Austriake për Paqen dhe Zgjidhjen e Konfliktëve në StadtSchlanining, Austri, në janar 2005; kursin e specializimit të Komisionit Evropian për sundimin e ligjit në Akademinë Folke Bernadotte në Sändowerken, Suedi, në prill 2005, dhe kursin e specializimit të Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Scuola Sant’Anna në Pisa, Itali, maj 2005.

Që nga vitit 2008 ai është ekspert për të Drejtat e Njeriut për Komisionin Evropian / T.A.I.E.X., duke marrë pjesë në një cilësi të tillë në Misionin Shqyrtues të Ekspertëve në ish-Republikën Jugosllave

të Maqedonisë, në maj 2010 dhe ka marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit shtetëror të Egjiptit, në Kajro, në prill 2013.

Ai ka diplomuar për të Drejtat e Njeriut në nivelin pas universitar, në korrik 2010, nga Shkolla e Juridikut në Universitetin e Minhos në Braga dhe poashtu ka kryer Masterin akademik rreth të Drejtave të Njeriut, në maj 2012, nga e njëjta Shkollë e Juridikut.

Nga muaji shtatori 2013 deri në nëntor 2015 ka punuar gjykatës ndërkombëtar i lëndëve penale në Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, në Prishtinë, Kosovë dhe njëherësh anëtar i Grupit Punues për Drejtësinë Penale, E.U.L.E.X. - Kosovë, autor i "Raportit për përpilimin e propozimeve të mëparshme dhe aktuale për ndryshimin e Kodit Penal të Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës". Po ashtu ai ka qenë kryesues i Këshillave Disiplinorë të Apelit, EULEX-i Kosovë, Prishtinë, Kosovë, ndërsa që nga nëntori i vitit 2015 e deri më tani është gjykatës ndërkombëtar i lëndëve penale në Gjykatën Supreme të Kosovës, në Prishtinë.

Ka ndjekur disa trajnime, seminare dhe konferenca, duke përfshirë edhe folës mysafir në Portugali, Spanjë, Slloveni, Poloni, Bosnjë, Kosovë, Francë dhe Gjermani. Është hulumtues në Qendrën Kërkimore për Drejtësi dhe Qeverisje, të Drejtat e Njeriut, Universiteti Jusgov i Minhos, Portugali.

Ai është autori i punimit "*O Direito do Homem a Rejeitar a Paternidade de Filho Nascido Contra a Sua Vontade. A Igualdade na Decisão de Procriar*" (E drejta e burrit për të refuzuar atësinë e një fëmije të lindur kundër vullnetit të tij. Barazia në vendimin për lindje), Coimbra, Coimbra Editora, maj 2013 dhe bashkautor në veprën e përbashkët "*A Lei Tutelar Educativa Portuguesa. Medidas Educativas Não-Institucionais*" (Ligji arsimor dhe korrektues portugez për të miturit). Masat korrigjuese jo-institucionale dhe sanksionet), Lisbonë, Shkolla portugeze e gjykatëse dhe prokurorëve, C.E.J., dhjetor 2008.

Aktualisht është student për doktoratë në Shkencat e Përgjithshme Juridike (2014-2018) në Shkollën e Juridikut të Universitetit të Minho në Braga.

Z. Martins Riberiro është emëruar anëtar zëvendësues i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nga shefja e Misionit EULEX-i Kosovë në dhjetor 2017.

## **8.2. Sekretariati**

Në vitin 2017 Sekretariati i Panelit është përbërë prej një zyrtari të lartë ligjor dhe dy përkthyes.

### **Z. John J. Ryan**

John J. Ryan, shtetas i Irlandës dhe ish-oficer ushtarak, ka diplomuar në juridik me titullin Bachelor (Hons) për Drejtësi dhe Studime Evropiane nga Universiteti i Limerick-it, Irlandë, dhe ka diplomë pasuniversitare si avokat nga Shoqata e Avokatëve të Irlandës. Ai ka punuar si avokat në Stephen MacKenzie dhe Co. Solicitors në Dublin, Irlandë. Ai ka shërbyer në Kombet e Bashkuara në Liban, Siri, Izrael, Kamboxhia, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Timor Lindor, Nepal, Kosovë, dhe si konsulent i Komisionit Evropian në Kinë. Para se të merrte detyrën e tij të tanishme, kishte punuar në UNMIK, *ndër të tjera* si administrator në Komunën e Zveçanit në regjionin e Mitrovicës, shef i Divizionit për Mbështetje Gjyqësore Ndërkombëtare - Departamenti i Drejtësisë, zëvendës këshilltar ligjor, Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara (O/PSSP) - UNMIK, dhe zyrtar ekzekutiv, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (O/PSSP). Në pozitën e

tanishme si zyrtar i lartë ligjor dhe shef i Sekretariatit, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i BE-së ai është emëruar në prill 2010. Artikujt e tij rreth Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK dhe Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian janë botuar në revistën vjetore të Forcave të Mbrojtjes të Irlandës në vitin 2010 dhe 2015.

#### **Znj. Katica Kovacevic**

Znj. Katica Kovacevic, serbe e Kosovës, ka qenë e punësuar më parë si asistente administrative/gjuhësore (serbisht/anglisht) në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm nga maji i vitit 2003 deri në dhjetor të vitit 2008 dhe si asistente gjuhësore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nga janari i vitit 2009 deri në nëntor të vitit 2010. Ajo e filloi punën si përkthyes në Sekretariatit e Panelit në dhjetor të vitit 2010.

#### **Z. Kushtrim Xhaferi**

**Z. Kushtrim Xhaferi**, shqiptar i Kosovës, ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës, Kosovë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ai më parë ka punuar si përkthyes (shqip/anglisht) në Korporatën Energjetike të Kosovës nga shkurti i vitit 2004 deri në janar të vitit 2009, e më pas si asistent gjuhësor në Komponentin e Policisë së EULEX-it. Ai punon si përkthyes në Sekretariatit e Panelit që nga shtatori i vitit 2010.

### **8.3. Ish-personeli i Panelit dhe Sekretariatit**

#### **Z. Antonio Balsamo**

Shih pjesën 7 më lartë.

#### **Znj. Verginia Micheva-Ruseva**

Znj. Verginia Micheva-Ruseva u diplomua nga Universiteti i Sofjes në Bullgari në nivelin e magjistratit të drejtësisë në vitin 1995 dhe ka kaluar provimin shtetëror të Bullgarisë për postet gjyqësore në dhjetor 1995. Gjithashtu ka kryer kurse të ndryshme ligjore, duke përfshirë edhe kurset mbi ligjin e të drejtave të njeriut, për çka ka marrë certifikata. Ajo ka shërbyer si gjykatëse gjatë gjithë karrierës së saj pesëmbëdhjetë vjeçare profesionale. Ka filluar karrierën e saj gjyqësore si gjykatëse e re, pastaj ajo më vonë shërbeu si gjykatëse e gjykatës komunale për tetë vjet dhe pastaj u emërua gjykatëse e gjykatës së qarkut nga këshilli i lartë gjyqësor.

Në gjykatën komunale dhe në nivelin e gjykatës së qarkut znj. Micheva-Ruseva është marrë me raste civile dhe penale, duke përfshirë shkeljet e të drejtave të njeriut në rastet e diskriminimit të paligjshëm, diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, ngacmimit seksual, qasjes në informata personale, zbulimit të informatave dhe mjeteve juridike, konfiskimit të pasurisë, etj. Përveç studimeve për të drejtat e njeriut gjatë magjistraturës, ajo ka përfunduar shumë kurse rreth Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe protokolleve të saj, gjithashtu si gjykatëse e re ajo ka studiuar jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në shtator të vitit 2008 ajo ka marrë pushim të jashtëzakonshme nga gjykata e saj shtetërore pasi u emërua që të shërbej si gjykatëse civile në nivelin e gjykatës së qarkut në Misionin e EULEX-it në Kosovë. Znj. Micheva-Ruseva është emëruar anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it nga shefi i Misionit të EULEX-it më 6 korrik 2011.

## **Z. Francesco Florit**

Z. Francesco Florit, shtetas Italian, ka diplomuar për Drejtësi në Universitetin e Triestes në vitin 1988 ku është dekoruar me vendin e parë për disertacionin e tij mbi të drejtën e tatimeve dhe të drejtën tregtare. Ai ka përfunduar një vit studime në Universitetin e Drejtësisë në Edinburg mbi Gjykatat Britanike, sistemin e të drejtës penale dhe sistemin e të drejtës zakonore në kuadër të Projektit për Juristët e Rinj Evropian në vitin 1998. Ai e kreu provimin e jurisprudencës më 1990 dhe punoi si avokat në sektorin e të drejtës së punës. Pas studimeve të mëtejshme dyvjeçare, ai e kaloi me sukses edhe provimin për t'u bërë gjykatës në vitin 1992.

Si gjykatës është marrë me çështjet e të drejtës civile dhe penale për të specializuar më pas në të drejtën penale. Ai punoi si Gjykatës Ndërkombëtar me UNTAET në Timorin Lindor dhe në Panelin Special për Krime të Rënda prej vitit 2002 – 2005 ku i ka shqyrtuar rastet e krimeve kundër njerëzimit të kryera nga Armata Indoneziane. Ai është dërguar nga Qeveria e Italisë në Misionin për Sundimin e Ligjit të EULEX-it (Komponenti I Drejtësisë) në mars 2008. Që nga fillimi i funksionimit më 9 dhjetor 2008 ka punuar gjykatës ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë duke u marrë me rastet më të rënda të veprave penale.

## **Znj. Gabriele Gaube**

Znj. Gabriele Gaube, shtetase gjermane, ka diplomuar për drejtësi në Universitetin Trier në Republikën Federale të Gjermanisë në vitin 1990. Pas përfundimit të studimeve pasuniversitare si dhe të provimit të dytë shtetëror, ajo fitoi titullin pasuniversitar në drejtësi në vitin 1993. Atë vit ajo është emëruar gjykatëse në Gjykatën Administrative në Berlin, ku ajo shërbeu deri në delegimin e saj në muajin mars të vitit 1999 në Ministrinë e Drejtësisë në Berlin, Departamenti për Arsimit dhe Aftësim/Bordi për Shqyrtimin e Ligjeve. Pas delegimit të saj në muajin janar të vitit 2003 ajo u emërua gjykatëse kryesuese e Gjykatës Administrative dhe në muajin dhjetor të vitit 2004 u emërua gjykatëse e Gjykatës së Lartë Administrative.

Në muajin janar 2005, ajo u rikthye në detyrën e saj në Gjykatën e Lartë Administrative në Berlin-Brandenburg (gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës më të lartë lidhur me legjislacionin e shteteve federale të Berlinit dhe Brandenburgut) ku, në muajin janar të vitit 2007, ajo u emërua zëvendës kryegjykatës. Nga muaji nëntor 2008, ajo ka qenë në një pushim të jashtëzakonshëm nga Gjykata e Lartë Administrative dhe është dërguar nga Republika Federale e Gjermanisë në misionin e EULEX-it në Kosovë. Atje, ajo u emërua gjykatëse ndërkombëtare në Panelin e Apeleve në Gjykatën Supreme për rastet e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Gjykatëse për Apele drejtuar Agjencisë Kosovare të Pronës, respektivisht nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe shefi i misionit EULEX në Kosovë në muajin janar 2009. Në muajin prill 2010, nga ajo është kërkuar që të mbulojë edhe proceset civile në përgjithësi si dhe proceset penale duke ju referuar kështu kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

## **Znj. Esma Özkan Erterzi**

Znj. Esma Özkan Erterzi, shtetase e Turqisë, ka diplomuar për drejtësi në Universitetin e Izmirit më 9 shtator 1990. Ajo i ka kaluar provimet shtetërore për t'u bërë gjykatëse në vitin 1991. Pas trajnimit ajo ishte marrë me çështjet penale dhe si dhe ato civile. Pasi që kishte shërbyer shtatë vite në gjykata, ajo ishte emëruar në Drejtorinë e përgjithshme të së Drejtës Ndërkombëtare dhe Punëve të Jashtme të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Turqisë. Ajo kishte përfaqësuar Ministrinë e Drejtësisë në shumë takime për të drejtën ndërkombëtare në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar. Ajo ka marrë certifikata nga Universiteti i Ankarasë, Turqi, rreth ligjit të Bashkimit Evropian (BE) dhe të drejtave për pronë intelektuale në vitin 2003. Në të njëjtin vit, ajo kishte

marrë bursën Jean-Monnet nga Komisioni Evropian. Në vitin 2004, ajo ka diplomuar në nivelin e magjistratit të drejtësisë (LLM) në Ligjin e Komunitetit Evropian nga Universiteti i Essex, në Mbretërinë e Bashkuar, ku kishte studiuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe Drejtësinë e BE-së si dhe Punët e Brendshme. Disertacioni i saj i magistraturës për Drejtësi ishte “Përputhshmëria e Ligjit Evropian rreth Migracionit të paligjshëm me të Drejtën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut”.

Në vitin 2005, ajo ishte emëruar në Kryeprokurorinë Publike të Gjykatës së Kasacionit si prokurore publike për tu marrë kryesisht me rastet e përdorimit të lëndëve narkotike, tregtisë me drogë, mashtrimeve financiare me çeçe dhe me çështje të tjera që lidhen me çeçe financiare si dhe me çështje ndërkombëtare të Zyrës në fjalë. Ajo ka përfaqësuar Kryeprokurorinë Publike të Turqisë në Samitin Botëror të Prokurorëve të përgjithshëm në Katar/Doha në vitin 2005, dhe në një Konferencë të Prokurorëve të përgjithshëm evropian nën kornizën e Këshillit të Evropës në Moskë në vitin 2006. Znj. Erterzi ka marrë pjesë në takimet shqyrtuese midis Komisionit Evropian dhe Republikës së Turqisë rreth Kapitullit 24: “Drejtësia, Liria dhe Siguria” në bisedimet rreth anëtarësimit të Turqisë në Bashkimin Evropian. Ajo ka shërbyer si trajnuese në seminare të ofruara për gjykatësit dhe prokurorët publik të Turqisë për dokumentin e Kombeve të Bashkuara, i ashtuquajtur Protokollin i Stambollit mbi atë se si të trajtohen akuzat për torturë, si të vlerësohen akuzat për torturë dhe qartësimi i masave mbrojtëse të drejtave të njeriut në Konventat ndërkombëtare.

Znj. Ertezi i ishte dhënë pushim i jashtëzakonshëm nga Këshilli i Lartë i Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik të Republikës së Turqisë në mënyrë që shërbej si gjykatëse ndërkombëtare në Misionin e EULEX-it që prej majit 2009. Ajo ishte emëruar si gjykatëse ndërkombëtare e Dhomës Speciale të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare për Mirëbesim. Znj. Erterzi ishte emëruar anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nga shefi i Misionit të EULEX-it më 10 janar 2011.

#### **Dr. Katja Dominik**

Dr. Katja Dominik, shtetase e Gjermanisë, ka studiuar për drejtësi dhe gjuhët sllave në Universitetin e Goettingen-it në Gjermani, ku ka diplomuar në vitin 1996. Dr. Dominik ka fituar bursë për studime pasuniversitare dhe i ka përfunduar studimet për aspektet ligjore të shpërbërjes së shtetit të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në Zagreb, Kroaci, në vitin 1998/99. Disertacioni i saj për këtë temë ishte botuar në vitin 2001.

Nga viti 2000 deri në vitin 2002 ajo ka punuar për periudha të ndryshme si nëpunëse ligjore në Gjykatën e Lartë Rajonale në Dyseldorf dhe gjithashtu në zyrën e avokatisë e specializuar në ligjin për azil. Në vitin 2002 ajo ishte punësuar nga Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik në Bon, ku kishte punuar në Sektorin për politikën zhvillimore evropiane. Në këtë cilësi, ajo ka hulumtuar dhe përpiluar tekste dhe fjalime për konferenca ndërkombëtare për ndihmë zhvillimore në Bruksel dhe Bon, ku ajo gjithashtu në disa raste e ka përfaqësuar qeverinë gjermane.

Në tetor të vitit 2002, Dr. Dominik është emëruar gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Dyseldorf, ku është specializuar në fusha të ndryshme të drejtës penale. Më pas, ajo ishte bërë zëvendës kryetare në dhomën penale të Gjykatës së Qarkut për krime të rënda kapitale dhe krime ekonomike. Dr. Dominik është emëruar gjykatëse ndërkombëtare në EULEX-i Kosovë në tetor të vitit 2011, ku është caktuar në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, ku është marrë me raste të profilit të lartë të krimeve të luftës, vrasjeve, korrupsionit dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Shefi i misionit EULEX e ka emëruar Dr. Dominik anëtare të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

të Bashkimit Evropian në janar të vitit 2013. Në dhjetor 2016 ajo mori pozitën e ushtruesit të detyrës së sheshe të Divizionit Ekzekutiv të EULEX-it dhe që nga janari 2017 ajo është emëruar sheshe e Divizionit Ekzekutiv.

### **Znj. Noora Aarnio**

Zj. Noora Aarnio, shtetase e Finlandës, ka diplomuar për Juridik në nivelin Master në Universitetin e Helsinkit, Finlandë, në vitin 2004. Ajo e ka kryer një trajnim njëvjeçar për gjykatëse në Gjykatën e Qarkut të Lohja Finlandë, në vitin 2005, për të marrë kualifikimin për të punuar gjykatëse. Prej muajit janar 2006 deri në shkurt 2010 ajo ka qenë e punësuar si ndihmës gjykatëse, fillimisht në Gjykatën e Sigurimeve dhe pastaj në Gjykatën e Apelit në Helsinki. Më pas, ajo ka punuar zyrtare ligjore në EULEX, fillimisht për një vit në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë e pastaj edhe dy vjet në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ajo u kthye në Finlandë për të punuar gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Pirkanmaa, ku ka punuar prej muajit gusht 2013 deri në tetor 2014. Pas kësaj, ajo ka punuar këshilltare ligjore në Njësinë Ndërkombëtare të Departamentit të Administratës Gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë të Finlandës prej muajit tetor 2014 deri në dhjetor 2015. Ajo u kthye në EULEX në prill 2016 kur ka punuar zyrtare ligjore në Gjykatën e Apelit/Gjykatën Supreme të Kosovës deri në nëntor 2016, kur u emërua zyrtare ligjore në Sekretariatit e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut.

### **Znj. Joanna Marszalik**

Zj. Joanna Marszalik, shtetase e Polonisë, ka diplomuar për Juridik në nivelin Master nga Universiteti i Jagiellonian-it në Krakow, Poloni. Për pesë vite ajo ka punuar si juriste në Sekretarinë e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë. Më pas ajo ishte menaxhere e projektit të Këshillit të Evropës për ndërtimin e institucioneve “Mbështetja për Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë” dhe udhëheqëse ekipi e projektit të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Transparenca dhe Efikasiteti i Sistemit Gjyqësor në Ukrainë”, i cili i ka mbështetur reformat e sistemit gjyqësor të Ukrainës. Ajo iu bashkua misionit të OSBE-së në Kosovë në dhjetor të vitit 2010, ku ka punuar si zyrtare e lartë e të drejtave të njeriut, duke mbikëqyrur Qendrën Rajonale në Prishtinë. Ajo u emërua si zyrtare ligjore në Sekretariatit e Panelit në prill të vitit 2012. Që nga tetori 2016 ajo ka punuar si zyrtare e projektit për projektin e Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian “Fuqizimi i kornizave institucionale për qeverisjen lokale (Azerbaixhan, Armeni, Gjeorgji, Moldavi, Ukrainë dhe Belarusi)”.

### **Z. Paul Landers**

Z. Paul Landers, shtetas i Irlandës, është avokat që ka diplomuar në Honourable Society of King’s Inns, Irlandë. Ai ishte ftuar në Odën e Avokatëve të Republikës së Irlandës. Ai gjithashtu ka diplomë pasuniversitare në të drejtat e njeriut dhe drejtësi penale në Universitetin Queen’s University në Belfast, Irlandë e Veriut. Ai është ish-anëtar i Garda Síochána (Policia irlandeze) ku ka shërbyer për 15 vjet në Njësinë Speciale Detektive. Më pas, ai mori postin e këshilltarit ligjor dhe për të drejta të njeriut në Garda Síochána. Z. Landers më parë ka punuar si zyrtar ligjor në Zyrën për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Ligjore të EULEX-it. Para se ta merrte detyrën e tij të tashme, ai ishte i punësuar në Misionin për sundimin e ligjit në gadishullin verilindor të Afrikës, si sheshe i shtyllës së Policisë me përgjegjësi në Xhibuti, Somali, Somaliland, Puntland, Sejshell dhe Tanzani. Ai ishte emëruar zyrtar ligjor i Sekretariatit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të BE-së në gusht 2015.

## **Z. Florian Razesberger**

Z. Florian Razesberger, shtetas i Austrisë, ka studiuar për juridik në Universitetet e Vjenës, Kopenhagës dhe të Insbrukut (Magjister iuris 2001, Doctor iuris 2005). Fillimisht ka punuar si nëpunës juridik në Gjykatën Rajonale të Insbrukut dhe është emëruar zyrtar ndihmës ligjor në Kryesinë dhe Dhomat e Gjykatës Ndërkombëtare Penale në Hagë. Më pas është emëruar këshilltar ligjor në OJQ britanike për ndihmë juridike – Asistencë për refugjatë në lindjen e mesme të Afrikës në Kajro të Egjiptit. Pas kësaj është emëruar zyrtar ligjor në sektorin e reformave gjyqësore dhe të drejtat e njeriut në Misionin e OSBE-së në Shkup dhe Sarajevë (ku ka punuar për pesë vite). Më vonë ai po ashtu është emëruar zyrtar për të drejtat e njeriut dhe udhëheqës i ekipit për Misionin e Kombeve të Bashkuara për Asistencë në Afganistan. Para se të bëhej pjesë e Sekretariatit të PShDNj, ai ka punuar si ekspert për të drejtat e njeriut në EULEX.

## **Zj. Leena Leikas**

Zj. Leena Leikas, nënshtetase e Finlandës, ka diplomë të studimeve Master të juridikut nga Universiteti i Turku në Finlandë dhe është gjykatëse. Pas disa vitesh në Departamentin e Hartimeve Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë ajo është punësuar nga Njësia për Gjykatat dhe Konventat e të Drejtave të Njeriut në Departamentin Ligjor të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ku ka bërë specializimin për çështjet e të drejtave ndërkombëtare të njeriut. Ajo ka punuar si juriste për përpunimin e lëndëve në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg të Francës nga nëntori 2007 deri në prill 2010. Ajo është emëruar zyrtare ligjore në Sekretariatit të Panelit në maj të vitit 2010.

## **Zj. Stephanie Selg**

Zj. Stephanie Selg, nënshtetase e Zvicrës, është diplomuar si magjistër i drejtësisë nga Universiteti i Bazelit dhe Gjenevës, në Zvicër. Gjatë studimeve, ajo ka specializuar në fushën e të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe ligjin e të drejtave të njeriut, dhe ka marrë certifikatë për të drejtën ndërkombëtare nga Universiteti i Gjenevës. Pas praktikës ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë Administrative të qarkut të Bazelit dhe Gjykatës së Apelit të Bazelit në Zvicër, ajo u punësua nga qeveria e Zvicrës si këshilltare ligjore dhe këshilltare e lartë ligjore në Pratinë e Përkohshme Ndërkombëtare në Hebron (TIPH) në Bregun Perëndimor, Izrael. Ajo ka qenë anëtare e Grupit të Ekspertëve Kombëtar të Zvicrës për ndërtimin e paqes civile që nga viti 2009. Nga tetori i vitit 2010 deri në prill 2011 ajo ka punuar si këshilltare ligjore dhe zyrtare për kërkime në fushën e së drejtës ndërkombëtare pranë Forumit zviceran për të drejtat e njeriut në Bernë të Zvicrës. Ajo u emërua si zyrtare ligjore pranë Sekretariatit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në qershor të vitit 2011.

## **Zj. Shpresa Gosalci**

Zj. Shpresa Gosalci, shqiptare e Kosovës, ka diplomuar nga studimet e Master për marketing biznesi dhe menaxhment nga Universiteti AAB, Prishtinë. Ajo ishte punësuar si përkthyes (shqip/serbisht/anglisht) në KFOR nga korriku i vitit 1999 deri në qershor të vitit 2000, si dhe si asistente administrative/gjuhësore në Zyrën për Informim Publik dhe Media të Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut nga qershori i vitit 2000 deri në mars të vitit 2009. Ajo e ka filluar punën e saj si asistente administrative/gjuhësore në Sekretariatit të Panelit në korrik të vitit 2010.



## **9. Çështjet operative dhe administrative**

### **9.1. Buxheti**

Në vitin 2017, si në vitet e mëparshme Panelit i është ndarë një buxhet i veçantë për fushatën informuese dhe materiale reklamuese. Kjo i mundëson Panelit që të marrë vendime për zbatimin e fushatës e informimit publik, në veçanti për transmetimet në TV dhe/apo në radio, pa ndikim mbi burimet buxhetore në diskrecion të EULEX-i Kosovë.

Megjithatë, burimet buxhetore plotësuese do t'i ndihmojnë në masë të madhe Panelit gjatë punës së tij të përditshme. Kjo do ta rrisë edhe më tej pavarësinë e vërtetë dhe të perceptuar të Panelit dhe kësaj do ta shtojë më tej besueshmërinë e EULEX-i Kosovë në lidhje me përkushtimin e tij për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

### **9.2. Burimet njerëzore**

Sekretariati i Panelit ishte ndikuar negativisht në aspektin e personelit që nga ri-konfigurimi i EULEX-it në qershor të vitit 2016. Paneli e ka humbur një pozitë të zyrtarit ligjor gjatë ri-konfigurimit dhe një pozitë të asistentit administrativ/gjuhësor. Përveç kësaj, dorëheqja e zyrtarit ligjor të dytë dhe procedura e gjatë e punësimit të një zyrtari ligjor të ri arriti deri tek situata ku Paneli/Sekretariati funksionoi me vetëm një zyrtar ligjor për pjesën më të madhe të vitit 2017.

Përveç kësaj, znj. Elka Ermenkova, anëtare e Panelit nga EULEX ka dhënë dorëheqje nga Paneli në dhjetor 2017.

Znj. Ermenkova u zëvendësua nga znj. Anna Bednarek si anëtare e plotë e EULEX në Panel. Z. Jorge Martins Ribeiro, gjykatës i EULEX-it, u emërua anëtarë zëvendësues i Panelit në dhjetor 2017.

## **10. Konkluzionet dhe rekomandimet**

### **Pranimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i**

Siç është theksuar në raportet e mëparshme, Paneli edhe një herë rekomandon që ShM-ja të pranojë shkeljet e të drejtave të njeriut që i atribuohen EULEX-it, meqë pranimi publik i përgjegjësisë për shkeljen e të drejtave të njeriut cilësohet në fushën e të drejtave të njeriut si formë e zgjidhjes efektive të shkeljes.

ShM-ja në mënyrë të vazhdueshme ka refuzuar ta bëjë këtë. Baza e këtij hezitimi duket se është brenga e ndërlidhur me mundësinë e përgjegjësisë dhe proceseve të mëtejme gjyqësore. Paneli nuk është i bindur nga ky argument. Së pari, pasi Paneli të ketë konstatuar një shkelje të tillë, një organ i Misionit praktikisht ka vendosur ashtu. Nuk ka pasur ndonjë të dhënë se është ngritur ndonjë padi si rezultat i konstatimeve dhe vendimeve të Panelit.

Gjithashtu, ky pranim mund të formulohet lehtë në atë mënyrë që nuk nënkupton pranimin e përgjegjësisë civile përtej asaj që tashmë ka mundur ta shkaktojë Misioni si rezultat i funksionit të tij. Më tej, në mungesë të mundësisë që, në bazë të regjimit që e rregullon atë, Paneli të rekomandojë kompensime financiare, pranimi i përgjegjësisë do të siguronte një mjet të

rëndësishëm (megjithëse shpesh të pamjaftueshëm) për korrigjimin e gabimit. Në bazë të kësaj, Paneli i bën thirrje ShM-së, në konsultim me autoritetet përkatëse, që t'i shqyrtojë më tej implikimet e këtij pranimi me qëllim që ShM-së në vijim t'i mundësohet shqyrtimi i ndryshimit të kësaj praktike.

### **Rastet e personave të vrarë dhe të zhdukur**

Është theksuar se UNMIK-u dhe EULEX-i e kanë nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit më 26 nëntor 2008 për modalitetet, të drejtat dhe obligimet përkatëse që burojnë nga bartja e lëndëve të personave të vrarë dhe të zhdukur d.m.th. “zhdukjeve me forcë” dhe dosjeve përkatëse prej UNMIK-ut tek EULEX-i lidhur me hetimet në proces, ndjekjet penale dhe veprimet e tjera që ishin ndërmarrë për këto lëndë deri në atë moment nga prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut.

Më tej është konstatuar se PKDNj i UNMIK-ut, në Raportin Përfundimtar të tij më 30 qershor 2016, ka rekomanduar që EULEX-i Kosovë duhet t'i vazhdojë hetimet për këto lëndë të personave të vrarë dhe të zhdukur në mënyrë që t'i përmbush kërkesat e nenit 2 të Konventës. Është e domosdoshme që të ndriçohen rrethanat e “zhdukjes me forcë” të këtyre pjesëtarëve të pakicave etnike, duke i përfshirë edhe kundërshtarët politikë dhe që autorët e supozuar nga radhët e UÇK-së dhe grupeve e tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës të sillen para drejtësisë.

Po ashtu, vlen të përmendet se kryesuesi i PKDNj-së ka theksuar se bartja e juridiksionit për këto raste tek autoritetet kosovare nuk ishte zgjidhje e zbatueshme meqë, mes tjerash, gati shumica e këtyre rasteve kishin të bënë me serbë të Kosovës si viktime. Ishte e kuptueshme që këta ankues ishin të brengosur për sigurinë e tyre në kohën kur i kanë parashtruar këto ankesa në UNMIK dhe më vonë në PKDNj dhe në fakt në shumicën e rasteve kishin kërkuar të mbeteshin anonimë.

Në frymën e vendimeve dhe konstatimeve të fundit të Panelit në lidhje me rastet e “zhdukjeve me forcë” gjatë periudhës raportuese, është rekomanduar që EULEX-i Kosovë ta shqyrtojë mundësinë e sigurimit të burimeve të domosdoshme njerëzore dhe materiale në mënyrë që të kryejë hetime gjithëpërfshirëse për rastet të cilat janë bartur nga UNMIK-u në EULEX Kosovë në nëntor 2008.

Paneli beson se zgjidhja efektive e këtyre lëndëve dhe mbështetja e të drejtave të të afërmve të viktimave, kërkon një qasje të përgjithshme që do të përfshinte të gjitha palët e përfshira – ShM-ja e EULEX-it Kosovë, PSBE-ja në Kosovë, autoritetet kosovare dhe të gjithë të tjerët që janë aktivë në Kosovë në lidhje me zgjidhjen e këtyre rasteve, në veçanti të rasteve të “zhdukjes me forcë”. Bashkimi i resurseve nga palët në fjalë dhe miratimi i një strategjie koherente ndërmjet këtyre aktorëve të ndryshëm është shumë me rëndësi dhe në fakt është e domosdoshme për t'i garantuar në mënyrë efektive të drejtat e të afërmve të personave të vrarë dhe të zhdukur.

Për të ndihmuar për atë proces, Paneli ka publikuar [“Letrën e bardhë” lidhur me çështjen e zhdukjeve](http://hrrp.eu/docs/Case%20law%20Note%20on%20Disappearance.pdf) me qëllim të ofrimit të një kornize të përgjithshme për të drejtat e njeriut brenda së cilës palët përkatëse duhet të përpiqen për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Gjithashtu, Paneli ka publikuar një shënim hulumtues/analitik ku përmbledhet jurisprudenca e vet në lidhje me lëndët e zhdukjeve me forcë. <http://hrrp.eu/docs/Case%20law%20Note%20on%20Disappearance.pdf>.

### **Prioritetizimi i lëndëve**

Një numër i ankesave të paraqitura në Panel kishin të bënë me pohimet për hetime jo të duhura, jo të plota apo jo-ekzistuese sa i përket pretendimeve serioze për shkeljet e të drejtave nga ana e Misionit. Paneli ka përcaktuar se një numër i këtyre ankesave kishin bazë dhe se shkeljet në këtë kontekst kishin ndodhur. Si pjesë e vlerësimit të tij të këtyre rasteve, Paneli menjëherë ka vërejtur

një numër të problemeve sistematike lidhur me trajtimin e këtyre rasteve, duke përfshirë bashkërendimin jo të duhur me Misionin dhe regjistrimin jo të duhur të lëndëve, etj.

Një prej këtyre çështjeve sistematike duket sa ka të bëjë me mosprioritizimin e lëndëve nga ana e prokurorëve të EULEX-it që në mënyrë të qartë dhe të dukshme ngritin çështje serioze të të drejtave të njeriut. Në veçanti këto përfshijnë shumë rasteve të pa-hetuara apo të hetuara në mënyrë jo të duhur të zhdukjeve me forcë që ndërlidhen me konfliktin në Kosovë. Po ashtu, ato kanë të bëjnë me një numër të lëndëve të rënda që kanë të bëjnë me të drejtat themelore të pakicave, duke e përfshirë lëndën [2011-20 X dhe 115 ankuesit tjerë](#) (lënda e romëve), e cila është parashtruar në PKDNj të UNMIK-ut <http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Cases%20Eng/26-08%20NM%20etal%20Opinion%20FINAL%2026feb16.pdf> dhe PShDNj <http://hrrp.eu/docs/decisions/Decision%20and%20findings%202011-20%20pdf.pdf>. Prandaj duket se është shumë me rëndësi që gjatë ushtrimit të detyrave të mbetura hetimore dhe prokuroriale të tij, ky Mision duhet të përpiqet që t'u jep një shkallë të caktuar të prioritetit dhe urgjencës hetimit efektiv të këtyre rasteve që kanë të bëjnë me shkeljet e rëndë dhe sistematike të të drejtave të njeriut.

### **Vazhdimi i fuqizimit të sundimit të ligjit në Kosovë**

Është me rëndësi që vendet e BE-së, në veçanti përmes EULEX-i Kosovë, t'i përkrahin angazhimet në Kosovë për fuqizimin e sundimit të ligjit. Garantimi i pavarësisë, paanësisë dhe efektivitetit të gjyqësorit si dhe sigurimi i hetimit efektiv të shkeljeve të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur ë Kosovë duhet të mbesin prioritet i Misionit dhe vetë BE-së. Veçanërisht me rëndësi në këtë kontekst është përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të pakicave me qëllim që të parandalohet çfarëdo lloji diskriminimi, veçmas ai në bazë të përkatësisë etnike apo fetare.

### **Programi i reparacionit**

Pagesa e kompensimit për ankuesit dhe anëtarët përkatës të familjeve të tyre është një temë konstante në domenin publik në rast të kryerjes së shkeljeve të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë. Fakti që ankesa arsyetohet me konstatimin e shkeljes së të drejtave të njeriut është ngushëllim i vogël në kontekstin e të drejtave themelore për të cilat bëhet fjalë në këto raste.

Prandaj rekomandohet që EULEX-i të shqyrtojë me seriozitet krijimin e një programi të plotë dhe gjithëpërfshirës të reparacionit, i cili do të përfshinte kthimin e pronës, kompensimin, rehabilitimin, satisfaksionin dhe garancitë për mos-përsëritje, për viktimat, ankuesit, pjesëtarët dhe anëtarët e familjeve të tyre përkatës.

### **Çështjet e tjera të të drejtave të njeriut që ndërlidhen me ri-konfigurimin e Misionit, të planifikuar për muajin qershor 2018**

Misioni është paraparë që t'i reduktojë aktivitetet e tij gjatë vitit 2018. Kjo gjë ngrit një numër të çështjeve dhe sfidave të mundshme nga pikëpamja e mbrojtjes efektive e të drejtave të njeriut në Kosovë, të cilat i ka identifikuar Paneli si në vijim:

- i. **Personeli:** Efektiviteti i Misionit varet nga prania dhe përkushtimi i vazhdueshëm i personelit të kualifikuar. Në mënyrë që Misioni të ketë sukses dhe ta përmbush mandatin e tij, numri përgatitja e personelit duhet të përkojë me natyrën dhe shtrirjen e mandatit të Misionit.

Prandaj, është me rëndësi që Misioni të vazhdojë ta ketë numrin e mjaftueshëm të personelit, i cili a) përkon me natyrën dhe fushëveprimin e mandatit të tij, dhe b) i cili e pasqyron nivelin e duhur të njohurive dhe përvojës për të siguruar që Misioni të vazhdojë respektimin e obligimeve të tij përkitazi me të drejtat e njeriut.

- ii. **Tranzicioni dhe korniza ligjore e nevojshme:** Është me rëndësi për BE-në dhe shtetet anëtare që të sigurojnë që Misioni të jetë në gjendje të funksionojë gjatë gjithë kohës në kuadër të kornizës ligjore përkatëse dhe të domosdoshme. Ndonjë mandat i ri apo i ndryshuar i Misionit duhet të ketë plotësisht parasysh këtë fakt.
- iii. **Bartja e lëndëve dhe shkresave të lëndëve:** Bartja e dosjeve dhe e të dhënave nga autoritetet e BE-së tek ato vendore ngrit një numër të çështjeve të rëndësishme (nganjëherë kundërthënëse) të të drejtave të njeriut, duke përfshirë: të drejtën për të vërtetën dhe për hetime për viktimat e të drejtave të njeriut; qasjen në informacione; çështjet e konfidencialitetit për materialet e ndjeshme. Është me rëndësi që të shqyrtohen me kujdes implikimet e të drejtave të njeriut lidhur me këto bartje.
- iv. **Hetimet penale në proces e sipër:** EULEX-i mbetet i përfshirë në një numër të hetimeve penale. Hetimet penale përbëjnë një element thelbësor të sundimit të rendit dhe ligjit. Është me rëndësi që BE-ja t'i shqyrtojë ato si të tilla dhe duhet t'i kushtojë vëmendje të kujdesshme nevojës për ta vazhduar përfshirjen e Misionit në to, veçanërisht në lidhje me hetimet në proces e sipër, të cilat duhet të vazhdohen dhe të përfundohen me nivelin e duhur të efektivitetit dhe shpejtësisë.
- v. **Dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë:** Po ashtu, çështja e bartjes së lëndëve dhe hetimeve penale (të EULEX-it) në proces e sipër ngrit çështjen më të ndjeshme lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve (të mundshëm) dhe bashkëpunëtorëve të tjerë të drejtësisë (informatorëve, zyrtarëve gjyqësorë, etj.). Po që se do hapeshin të gjitha dosjet, do të mund të vinte deri te qasja e palëve të treta në këto informacione dhe për pasojë mund të shkaktoheshin kërcënime të sigurisë për individët në fjalë. Duhet kushtuar vëmendje e kujdesshme rreth kësaj çështjeje si dhe mënyrës më të mira për ta siguruar vazhdimin e mbrojtjes së

dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë në përputhje të plotë dhe efektive me të drejtat themelore të tyre.

- vi. **Dosjet e Misionit:** Misioni ka mbledhur dhe ka krijuar dosje të mëdha lidhur me aktivitetet e veta. Disa prej tyre mund të jenë me rëndësi për çështjet që mund të paraqiten pas mbylljes së Misionit. Gjithashtu, ato mund të përfshijnë çështjen e të drejtave të njeriut. Është me rëndësi që Misioni duhet të sigurojë që dosjet e veta të ruhen, organizohen, mirëmbahen dhe të barten në mënyrën e duhur tek autoritetet kompetente. Për këtë arsye, Misioni duhet gjithashtu t'i zbatoj disa politika, në veçanti sa i përket a) ruajtjes, b) qasjes, c) procedurave për qasje dhe autoritetit kompetent për dhënien e qasjes, d) çështjes së imunitetit dhe e) konfidencialitetit.
- vii. **Zhdukjet e dhunshme:** Zhdukjet e dhunshme mbeten njëra prej sfidave më të mëdha me të cilat ballafaqohet Misioni. Kjo çështje nuk është trajtuar në mënyrë të duhur deri më tani nga ndonjë prej aktorëve përkatës (OKB-ja; EULEX-i; autoritetet vendore). Kjo mbetet në masë të madhe një çështje që duhet të trajtohet përfundimisht dhe në mënyrën e duhur. BE-ja duhet të sigurojë që kjo të mbetet një prej çështjeve kryesore në çfarëdo lloj diskutimi lidhur me të ardhmen e angazhimit të këtij Misioni dhe BE-së në Kosovë.
- viii. **Roli dhe mandati i ardhshëm i Misionit:** Po që se Misioni do të vazhdojë të ekzistojë, qoftë edhe me mandat të kufizuar, pas afatit të tanishëm (qershor 2018) të paraparë për ri-konfigurim, Paneli rekomandon fuqishëm që ai duhet të vazhdojë të përqendrohet në mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut.
- ix. **Të drejtat dhe mbrojtja e pakicave:** Mbrojtja e pakicave mbetet një çështje kryesore sociale dhe politike në Kosovë. Po ashtu, kjo është një prej sfidave më të rëndësishme të të drejtave të njeriut për Misionin dhe për Kosovën në përgjithësi. BE-ja dhe çfarëdo misioni i ardhshëm duhet të sigurojnë që kjo çështje të mbetet një prioritet i lartë i autoriteteve vendore dhe se të drejtat e pakicave në Kosovë të mbrohen në mënyrën e duhur dhe efektive.
- x. **Çështjet e trashëgimisë:** Si pjesë e procesit të tranzicionit, Paneli dëshiron të rekomandojë që Misioni duhet të hartojë një vlerësim të drejtë, të

ekuilibruar dhe të sinqertë të punës së tij, duke u përqendruar në mënyrë të posaçme në çështjet e të drejtave të njeriut (të kaluara, të tanishme dhe të ardhshme). Paneli rekomandon një përqendrim të veçantë në këto: a) mangësitë e identifikuara të Misionit sa i përket të drejtave të njeriut (të kaluara ose të tanishme) dhe b) sfidat e ardhshme apo të pazgjidhura të të drejtave të njeriut në Kosovë. Është me të vërtetë e rëndësishme që BE-ja, shtetet dhe akterët e tjerë të mund të mësojnë nga Misioni në mënyrë që përmirësohet puna e tij në misionin e ardhshëm si dhe të përpiqet t'i adresojë çështjet e pazgjidhura. Si pjesë e këtij procesi, Paneli gjithashtu rekomandon që të bëhen konsultime ndërmjet Misionit dhe akterëve të tjerë përkatës për të drejtat e njeriut (përfshirë OJQ-të, shoqërinë civile, avokatin e popullit, etj.) në mënyrë që t'i ndihmoj Misionit në identifikimin e sfidave të pazgjidhura të të drejtave të njeriut, të cilat do të shërbejnë si informata për qëndrimin e BE-së lidhur me të ardhmen e Misionit dhe të marrëdhënies së saj me Kosovën.

- xi. **Fusha e drejtësisë:** Kjo fushë është veçanërisht e ndjeshme pasi që është një prej shtyllave të sundimit të ligjit. Po ashtu, ajo është veçanërisht me rëndësi në kontekstin e Kosovës si një akter kryesor i tranzicionit drejt një demokracie plotësisht funksionale. Duhet bërë ende përmirësime të mëdha për të siguruar që drejtësia ta luajë funksionin e saj kryesor sa i përket mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut në Kosovë.
- xii. **Edukimi për të drejtat e njeriut dhe promovimi i tyre:** Aktivitetet edukative dhe promovuese rreth të drejtave të njeriut janë mënyra të rëndësishme për përhapjen dhe promovimin e njohurive rreth të drejtave të njeriut në kuadër të komunitetit. Është me rëndësi që BE-ja dhe Misioni të luajnë rolin e tyre lidhur me rritjen e nivelit të të kuptuarit të këtyre çështjeve në Kosovë.
- xiii. **Vazhdimi i ekzistimit të Panelit:** Koncept Dokumenti për Llogaridhënie parasheh shprehimisht se "roli i Panelit është i lidhur me kohëzgjatjen e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Panel mund të funksionojë për një periudhë kohore plotësuese të kufizuar pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë, për aq kohë sa është e nevojshme që të shqyrtohen ankesat, të cilat janë ende duke u proceduar ose që do të

parashtrihen brenda afatit kohor prej gjashtë muajsh.” Andaj, Paneli e vlerëson të natyrshme vazhdimin e ekzistimit të vet pas muajit qershor 2018 në mënyrë që të siguroj që Misioni të vazhdojë t’i kryejë funksionet e veta në përputhje me të drejtat përkatëse të njeriut dhe të shërbejë si simbol i përkushtimit të BE-së ndaj të drejtave të njeriut dhe llogaridhënies për të gjithë.

**SHTOJCA 1 Tabela e personelit për vitin 2017**

<b>Paneli</b>	
<b>Magda Mierzewska</b>	Kryesuese e Panelit
<b>Guénaël Mettraux</b>	Anëtar i Panelit
<b>Elka Ermenkova</b>	Anëtare e Panelit, gjykatëse e EULEX-it
<b>Anna Bednarek</b>	Anëtare e Panelit, gjykatëse e EULEX-it
<b>Jorge Martins Ribeiro</b>	Anëtar zëvendësues i Panelit, gjykatës i EULEX-it

<b>Sekretariati</b>	
<b>John J. Ryan</b>	Zyrtar i lartë ligjor
<b>Noora Aarnio</b>	Zyrtare ligjore
<b>Katica Kovačević</b>	Përkthyes (serbisht-anglisht)
<b>Kushtrim Xhaferi</b>	Përkthyes (shqip-anglisht)



**SHTOJCA 2    Statistikat 2010 - 2017**

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Gjithsej
<b>Lëndët e regjistruara - gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>28</b>	<b>23</b>	<b>27</b>	<b>42</b>	<b>16</b>	<b>36</b>	<b>7</b>	<b>195</b>
<b>Lëndët e përfunduara - gjithsej</b>	<b>6</b>	<b>30</b>	<b>10</b>	<b>20</b>	<b>28</b>	<b>27</b>	<b>19</b>	<b>25</b>	<b>165</b>
Të pranueshme			2		1	8	0	0	<b>11</b>
Të papranueshme	6	22	10	13	22	12	9	14	<b>108</b>
Shkelje	0	2	0	7	2	4	9	1	<b>25</b>
Nuk ka shkelje	0	5	0	0	1	10	0	9	<b>25</b>
Të hequra nga lista	0	1	0	0	3	1	1	2	<b>8</b>

	<b>Më 31 dhjetor 2017</b>
Lëndët e papërfunduara	30
Të komunikuar te ShM-ja	23

### SHTOJCA 3 Vendimet nga PShDNj-ja 2010-2017

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2010-01	Djeljalj Kazagić	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, çështje pronësore	Shkelje
2010-02	Sadik Thaqi	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-03	Osman Mehmetaj	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-04	Feti Demolli	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-05	Mursel Hasani	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-06	Latif Fanaj	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-07	Blerim Rudi	Pretendim për moszbatim të urdhrit të lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për rikthim në punë të ankuesit nga ana e Njësisë së Inteligjencës Financiare	Shkelje
2010-08	Delimir Krstić	Pretendim për mosveprim nga policia dhe prokuroria e EULEX-it, çështje pronësore	E papranueshme
2010-09	Burim Ramadani	Pretendim për mos-funksionim të sistemit gjyqësor, rasti Kiçina	E papranueshme
2010-10	Horst Proetel	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë në EULEX	E papranueshme
2010-11	Laura Rudi	Ankesë private financiare ndaj një punëtori të EULEX-it	E papranueshme
2010-12	Hunaida Pasuli	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme
2010-13	Një punonjës i EULEX-it	Kontest i brendshëm në EULEX lidhur me vlerësimin e punës dhe marrëdhëniet personale me mbikëqyrësin	E papranueshme
2010-14	Lulzim Gashi	Kandidim i pasuksesshëm në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme

<b>Lënda</b>	<b>Ankuesi</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Rezultati</b>
<b>2010-15</b>	Faton Sefa	Mos rikthim në vendin e mëparshëm të punës (sektor privat), pretendim për mos zbatim të vendimit të gjykatës	E papranueshme
<b>2010-16</b>	Cyma Agovic	Transferuar nga EULEX-i – Mos shqyrtim i lëndës së ankueses në mënyrë të drejtë nga ana e gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-01</b>	Familja e Dedë Gecaj	Kërkesë për hetim të vendimit të gjykatave të EULEX-it në Kosovë për ekstradim në rastin e të ndjerit Dedë Gecaj	E papranueshme
<b>2011-02</b>	Chamalagai Krishna Bahadur	Pretendim për mosveprim	E papranueshme
<b>2011-03</b>	Afrim Mustafa	Kontest në lidhje me një radio stacion privat dhe konfiskimi i pajisjeve të radio stacionit	E papranueshme
<b>2011-04</b>	Besim Berisha	Ankesë rreth kushteve të jetës në burgun e Dubravës	E hequr nga lista
<b>2011-05</b>	SH.P.K "Syri"	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, DhPGjS	E papranueshme
<b>2011-06</b>	Milazim Blakqori	Pretendim për moszbatimin e një vendimi, mosveprim nga ana e EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-07</b>	Lënda W	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2011-08</b>	Anton Rruka	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, DhPGjS	E papranueshme
<b>2011-09</b>	Mirkovic Bojan	Pretendim për largim nga puna në mënyrë të paligjshme nga EULEX-i	E papranueshme
<b>2011-10</b>	Dejan Jovanović	Pretendim për vonesë të panevojshme gjatë procedurave në DhPGjS	E papranueshme
<b>2011-11</b>	Srecko Martinović	Pretendim për përdorim të tepruar të forcës, trajtim dhe mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2011-12</b>	Novica Trajković	Dyshohen në përdorim të tepruar të forcës	E papranueshme

<b>Lënda</b>	<b>Ankuesi</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Rezultati</b>
<b>2011-13</b>	S.M.	Pretendim për përdorim të tepruar të forcës, mohim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe mos respektim të jetës private	E papranueshme
<b>2011-14</b>	Lindita Shabani	Pretendim për mohim të së drejtës për jetë private dhe familjare	E papranueshme
<b>2011-15</b>	Samedin Smajli	Pretendim për mohim të gjyqimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
<b>2011-16</b>	Avdyl Smajli	Pretendim për mohim të gjyqimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
<b>2011-17</b>	Faik Azemi	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2011-18</b>	Mykereme Hoxha	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-19</b>	Sefer Sharku	Pretendim për mos respektim të një vendimi detyrues gjyqësor	E papranueshme
<b>2011-20</b>	X dhe 115 ankuesit e tjerë	Pretendim për mosveprim nga EULEX për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së personave që kanë jetuar në kampet rome të kontaminuara me plumb.	Shkelje
<b>2011-21</b>	Ventor Maznikolli	Pretendim për vonesë të panevojshme nga gjykatësit e EULEX-it rreth caktimit të një seance në Gjykatën Supreme	E papranueshme
<b>2011-22</b>	Hysni Gashi	Pretendim për mohim të një gjykimi të drejtë dhe Pretendim për paaftësi të gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-23</b>	Hashim Rexhepi	Pretendim për shkelje të së drejtës për liri dhe të së drejtës për gjykim të drejtë.	E papranueshme
<b>2011-24</b>	Predrag Lazić	Pretendim për mos caktimin e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm	E papranueshme
<b>2011-25</b>	Shaip Gashi	Pretendim për privim nga pensioni gjerman për persona me paaftësi	E papranueshme
<b>2011-26</b>	Njazi Asllani	Pretendim për mos zbatim të një vendimi, mosveprim nga EULEX-i	E papranueshme
<b>2011-28</b>	Lënda Y	Pretendim për shkelje të së drejtës për respektimin e jetës	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
		private dhe familjare.	
<b>2012-01</b>	Qamil Hamiti	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2012-02</b>	Arben Zeka	Pretendim për mos gjykim të një lënde pronësore	E papranueshme
<b>2012-03</b>	Rexhep Dobruna	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2012-04</b>	Izet Maxhera	Kontest pronësor me EULEX-in në Mitrovicë	E papranueshme
<b>2012-05</b>	Fatmir Pajaziti	Pretendim për shkelje të së drejtës për liri dhe gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2012-06</b>	Lënda Z	Pretendim për shkelje të nenit 10 dhe 11 të DUDNj-së, nenit 5 dhe 6 të KEDNj-së, nenit 9 të KDDCP-së dhe nenit 6 të KKT-së	E papranueshme
<b>2012-07</b>	Lënda I	Pretendim për mosveprim nga ana e prokurorit të EULEX-it dhe policisë së EULEX-it	E papranueshme
<b>2012-08</b>	Lënda U	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-09</b>	Lënda A	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-10</b>	Lënda B	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-11</b>	Lënda C	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-12</b>	Lënda D	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-13</b>	Bejtush Gashi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-14</b>	Valbone Zahiti	Pretendim për shkelje të nenit 8 të Konventës	Shkelje
<b>2012-15</b>	Shefqet Emerllahu	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mos hetim	E papranueshme
<b>2012-16</b>	Kristian Kahrs	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mosveprim	E papranueshme
<b>2012-17</b>	Lënda E	Pretendim për shkelje të neneve 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-18</b>	Hamdi Sogojeva	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-19</b>	Lënda H	Pretendim për konfiskim të pronës	Shkelje

<b>Lënda</b>	<b>Ankuesi</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Rezultati</b>
<b>2012-20</b>	Lënda G	Pretendim për shkelje të neneve 3, 10, 11 të KEDNj-së dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-21</b>	Mirko Krlić	Pretendim për shkelje të nenit 9 të KEDNj-së dhe nenit 2 të Protokollit 4 të KEDNj-së	Nuk ka shkelje
<b>2012-22</b>	Zoran Stanisić	Pretendim për shkelje të neneve 3, 6 dhe 8 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	Shkelje
<b>2012-23</b>	Predrag Blagić	Pretendim për shkelje të nenit 5 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista
<b>2013-01</b>	Lënda I	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-02</b>	Arsim Krasniqi	Pretendim për shkelje të nenit 3 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-03</b>	Goran Becić	Pretendim për shkelje të nenit 5 dhe 14 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2013-04</b>	J	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-05</b>	Lënda K	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
<b>2013-06</b>	Lënda L	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
<b>2013-07</b>	Lënda M	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
<b>2013-08</b>	Lënda N	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
<b>2013-09</b>	Lënda O	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
<b>2013-10</b>	Lënda P	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
<b>2013-11</b>	Lënda Q	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
<b>2013-12</b>	Lënda R	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
<b>2013-13</b>	Lënda S	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
<b>2013-14</b>	Lënda T	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
<b>2013-15</b>	Gani Zeka	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme

<b>Lënda</b>	<b>Ankuesi</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Rezultati</b>
<b>2013-16</b>	Almir Susaj	Pretendim për shkelje të nenit 3 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-17</b>	Ramadan Rahmani	Pretendim për shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-18</b>	Jovanka, Dragan, Milan Vuković	Pretendim për shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-19</b>	U	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-20</b>	Shaip Gashi	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-22</b>	Gani Gashi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-23</b>	V	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-24</b>	Emin Maxhuni	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-25</b>	Milorad Rajović	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-26</b>	Selami Taraku	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-27</b>	Shaban Kadriu	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-01</b>	Nexhat Qubreli	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-02</b>	Milica Radunović	Pretendim për shkelje të nenit 3, 8 dhe 13 i KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-03</b>	Lënda A.Z.	Pretendim për shkelje të nenit 1, 3, 6, 14 dhe 17 të KEDNj-së, nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E hequr nga lista
<b>2014-04</b>	Tomë Krasniqi	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-05</b>	Mazlam Ibrahimimi	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	E papranueshme
<b>2014-06</b>	Lënda B.Y.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-07</b>	Fitore Rastelica	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme

<b>Lënda</b>	<b>Ankuesi</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Rezultati</b>
<b>2014-08</b>	C.X.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-09</b>	Rifat Kadribasic	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-11</b>	Lënda D.W.	Pretendim për shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës	E pranueshme
<b>2014-18</b>	Fitim Maksutaj	Pretendim për shkelje të nenit 6 të Konventës	Shkelje
<b>2014-19</b>	Fahri Rexhepi	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-20</b>	Mensur Fezaj	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-21</b>	Shefki Hyseni	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 KEDNj-së	E hequr nga lista
<b>2014-22</b>	Ismajl Krapi	Pretendim për shkelje të nenit 5 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-23</b>	Shaip Selmani	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-24</b>	Lënda J.Q.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të Konventës	E papranueshme
<b>2014-25</b>	Nuha Beka	Kontest punësimi	E papranueshme
<b>2014-28</b>	Selatin Fazliu	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-26</b>	Ajet Kaçiu	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-27</b>	Qerim Begolli	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-29</b>	Shemsi Musa	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-30</b>	Abdilj Sabani	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-31</b>	Lënda K.P.	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-32</b>	L.O.	Pretendim për shkeljen e nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2014-33</b>	Arben Krasniqi	Pretendim për shkeljen e nenit 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-34</b>	Rejhane Sadiku Sylja	Pretendim për shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës	E pranueshme
<b>2014-36</b>	Lënda Z.A.	Pretendim për shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	E papranueshme



Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
<b>2014-38</b>	Slavica Mikic	Pretendim për shkelje të nenit 13 të Konventës	E papranueshme
<b>2014-39</b>	Musli Hyseni	Pretendim për shkelje të nenit 5 të Konventës	E hequr nga lista
<b>2014-40</b>	Avni Hajdari	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E hequr nga lista
<b>2014-41</b>	Liridona Mustafa Sadiku	Pretendim për shkeljen e nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-42</b>	Bujar Zherka	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-01</b>	Milos Jokic	Pretendim për shkelje të neneve 5, 6, 8, 9, 10 dhe 12 të Konventës	E papranueshme
<b>2015-03</b>	Dekart Shkololli	Pretendim për shkeljen e nenit 8 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-07</b>	Dobrivoje Radovanovic	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-08</b>	Afrim Berisha	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-09</b>	Driton Hajdari	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-10</b>	Shaban Syla	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2015-13</b>	Lënda W.D.	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>Vendimet 2017</b>			
<b>2016-03</b>	Afrim Islami	Pretendim për shkelje të nenit 6, dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	E papranueshme
<b>2015-04</b>	Nazmi Maloku	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-10</b>	Nikole Sokoli	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3 dhe 13 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2016-04</b>	Valon Jashari	Pretendim për shkelje të neneve 3, 6 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2016-02</b>	V.E.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2016-01	Skender Jashari	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-15	Đorđe Šmigić	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-12	U	Pretendim për shkelje të neneve 6, 13 dhe 14 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-11	Zvonimir Jovanović	Pretendim për shkelje të nenit 6, dhe nenit 1, Protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-06	X.C.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-05	Teresa Peters	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-35	M.N.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-14	Miodrag Konić	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2015-16	Vuleta Vošić	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2015-02	Ramadan Hamza	Pretendim për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2017-03	Alfred Bobaj	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-36	Namon Statovci	Pretendim për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe neneve 9 dhe 11 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-33	Agron Bytyçi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-27	Afrim Islami	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-26	T.G.	Pretendim për shkelje të nenit 8 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-25	Hilmi Krasniqi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-08	Hamdi Hasani	Pretendim për shkelje të nenit 8, dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-07	Mentor Qela	Pretendim për shkelje të nenit 3, 6 dhe 17 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-06 /2017-04	Shpresim Uka	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-05	Axhemi Zyhdi	Pretendim për shkelje të nenit 6, nenit 13 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-21	Thomas Rusche	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së	Shkelje
2011-27	F. dhe të tjerët	Pretendim për mos mbrojtje të dëshmitarit, e drejta për jetë	<b>Shkelje</b>